

UNIVERSITETI I EJL
УНИВЕРЗИТЕТ НАЈИЕ
SEEUNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ
LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTE

DREJTIMI: E DREJTA CIVILE

TEZA:

POLIGAMIA NË TË DREJTËN ISLAME – ASPEKTE KOMPARATIVE

KANDIDATI:

Muharem IDRIZILARI

MENTORI:

Doc. Dr. Arta SELMANI - BAKIU

Nëntor, 2020

DEKLARATË

Unë, Muharem Idrizilari deklaroj dhe vërtetoj se unë jam autori original i këtij punimi të magjistraturës me titull: **“POLIGAMIA NË TË DREJTËN ISLAME – ASPEKTE KOMPARATIVE”** dhe se të gjitha referencat e shënuara në këtë punim si dhe citimet apo shërbimet e ndryshme të marrura nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqeje si dhe në fund të këtij punimi. Me këtë rast, poashtu deklaroj se Universitetit ia barti të gjitha të drejtat autoriale të këtij punimi, për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Nëntor, 2020

Muharem Idrizilari, ID128429

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| PËRMBAJTJA..... | 3 |
| ABSTRAKT..... | 5 |
| HYRJE | 7 |
| 1. MARTESA | 12 |
| 1.1. Përkufizimi i martesës..... | 12 |
| 1.2. Dispozitat islame..... | 13 |
| 1.3. Urtësitë (funksionet) e martesës..... | 15 |
| 1.4. Ndarja e martesës në të drejtën Islame..... | 18 |
| 2. POLIGAMIA | 21 |
| 2.1. Përkufizimi i poligamisë | 21 |
| 2.2. Historiku i Poligamisë..... | 22 |
| 2.3. Rregullimi i poligamisë në jurisprudencën islame..... | 29 |
| Kurani si burim i së drejtës | 29 |
| Hadithi si burim i së drejtës..... | 30 |
| Mendimet e dijetarëve..... | 31 |
| 2.4. Shkaqet e poligamisë | 32 |
| 2.4.1 Shkaqet e përgjithshme të poligamisë. | 33 |
| 2.4.2. Shkaqet që ndërlidhen me dy bashkëshortëve | 36 |
| 2.5. Kushtet e poligamisë në jurisprudencën islame | 38 |
| 2.6. Të metat dhe dobitë e Poligamisë..... | 43 |
| Të Metat e poligamisë..... | 43 |
| Dobitë e poligamisë | 47 |
| 3. POLIGAMIA SIPAS LEGJISLACIONEVE | 48 |
| 3.1. Poligamia në legjislacionet e shteteve islame..... | 48 |
| 3.1.1. Shtete Islame të cilat e lejojnë poligaminë..... | 50 |
| 3.1.2. Shtete Islame që e lejojnë poligaminë në rrethana dhe kushte të caktuara | 53 |
| 3.1.3. Shtete Islame që e ndalojnë poligaminë | 61 |
| 3.2. Poligamia në ligjet e shteteve Evropiane | 64 |

| | |
|---|----|
| 3.2.1. Anglia | 64 |
| 3.2.2. Gjermania dhe Franca | 66 |
| 3.2.3. Shqipëria | 68 |
| 3.2.4. Kosova..... | 70 |
| 3.3. Poligamia në të drejtën familjare në Maqedoni | 71 |
| 3.4. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut | 73 |
| 4. Anketë..... | 75 |
| 4.1. Anketë me arabë | 75 |
| Egjipt..... | 75 |
| Arabia Saudite..... | 76 |
| Emiratet e Bashkuara Arabe | 77 |
| 4.2. Anketa me banorë që jetojnë në RMV | 78 |
| Të krishterë | 78 |
| Ateistë | 79 |
| Myslimanë | 80 |
| PËRFUNDIME | 82 |
| REKOMANDIME | 85 |
| BIBLIOGRAFIA | 86 |
| Libra dhe revista | 86 |
| Akte ligjore, kode..... | 94 |
| Burime nga interneti..... | 95 |

ABSTRAKT

Poligamia në të drejtën Islame është segment, veprimi i së cilës është i lejuar, por nga ana tjetër e shohim se një pjesë e njerëzve e kundërshtojnë atë, kurse e pranojnë që të legalizohet prostitucioni apo të ketë më shumë të dashura jashtë martesore.

Punimet paraprake që janë bërë në këtë fushë janë shumë pak, madje edhe ajo që është punuar është bërë sa për t'u zënë në gojë, madje në disa punime është bërë vetëm me qëllime përçmuese ndaj legjitimitetit që i jep Islami kësaj dukurie. Pikërisht kjo është njëra ndër arsyt që më shtyri të merrem me një punimi të këtillë shkencor.

Fillimisht kam nisur me tema të përgjithshme, por të rëndësishme, për studimin që do të jap në vazhdim.

Gjatë këtij punimi kam përdorur metoda të ndryshme, me shpresë për të arritur deri te argumentimi sa ma i drejtë dhe me një përfundim sa më të saktë rreth kësaj teme.

Vërtet është vështirë të punosh në një temë të tillë, sepse personalisht hasa në disa probleme, zgjidhja e të cilave kërkonte që të konsultoheshin edhe shumë libra të fushave të tjera, në veçanti të historisë, madje në shumë gjuhë të botës.

Gjatë punimit më është dashur të shfrytëzoj literaturë nga gjuha shqipe, maqedonase, serbe, kroate, angleze, turke, arabe etj.

АБРСТРАКТ

Полигамијата во исламското право е сегмент, чие дејствие е дозволено, но од друга страна гледаме некои луѓе кои се спротивставуваат на такво нешто, а додека го прифаќаат за легализирање на проституцијата или да има повеќе девојки надвор од брак.

Прелиминарната работа што е направена на ова поле е многу малку, дури и направеното е направено доволно за да се зборува, дури и во некои дела е направено само со презирни намери против легитимноста што исламот му ја дава на оваа појава. Ова е токму една од причините што ме натераа да се занимавам со ваков научен труд.

Првично започнав со општи, но важни теми, за студијата што ќе ја дадам во следното.

Во текот на овој труд користев различни методи, во надеж дека ќе дојдам до најправилниот аргумент и со најточниот заклучок за оваа тема.

Навистина е тешко да се работи на ваква тема, бидејќи јас лично наидов на некои проблеми, за чие решение беше потребно да се консултираат многу книги од други области, особено од историјата, па дури и на многу јазици во светот.

За време на работата морав да користам литература од албански, македонски, српски, хрватски, англиски, турски, арапски јазик итн

ABSTRACT

Poligamy in Islamic law os a segment,wich is action is accepted,but in the other side we see that some of people who oppose it, but they accept to legalize prostitution or to have more lovers out of wedlock.

Preliminary works which have been donein this field are slightly,even the work that has been worked is surfacely,even in some works is done just for contemtuous purposes on legitimacy that Islam gives on this occurence

This is exactly one of the reasons which encouraged me to work on this type of scientific work.

Initially I started with general topics but important for this study which I will give in the sequel.

While working I have used different methods,with hope to reach at the rightest justification and to the rightest conclusion about this topic. It is hard to work on this type of topic,because personally I encounteted in some problems,which is solutions demanded to consult with very more books of other fields,particulary of history,even in more foreign languages. While working I had to use literature of albanian language, macedonian, serbian, croatian, english, turkish, arabic etc.

HYRJE

Që nga kohërat e lashta të njerëzimit, njeriu për çdoherë është munduar që sistemin e jetës së tij ta përshtatë me rregullat njerëzore, prandaj edhe në këtë punim kemi filluar me pjesën e martesës dhe llojet e saja, pastaj kemi vazhduar me ndarjen e martesës në Islam duke u ndalur në veçanti tek poligamia apo martesë e një burri me më shumë se një grua. Si një koncept juridik, martesë trajtohet si qeliza e çdo shoqërie, ashtu siç thekson edhe sociologu i njohur Giddens: "Studimi i familjes dhe martesës përbën një nga fushat më të rëndësishme të sociologjisë, duke mos e mënjanuar as atë juridik".

Çdo njeri në të gjitha shoqëritë rritet në një mjedis familjar. Në çdo shoqëri, shumica dërrmuese e të rriturve janë të martuar ose kanë qenë të tillë. Prandaj edhe temën të cilës i jam qasur, jam munduar t'u përgjigjem disa pyetjeve të përditshme, si p.sh.: Si filloi poligamia? A ishte nevojë e asaj kohe poligamia? A është zgjidhje e problemit të prostitucionit? etj.

Gjatë punimit kemi cekur edhe llojet e martesës sipas Islamit, kam cekur mendime të dijetarëve të ndryshëm të cilët poligaminë e shohin në mënyra të ndryshme. Disa nuk e shohin të arsyeshëm një veprim të tillë, prandaj edhe them se poligamia sipas jurisprudencës Islame dhe ligjeve pozitive, a është drejtësi dhe zgjedhje e problemeve apo nxitje e mosmarrëveshjeve dhe padrejtësi

Në pjesë e dytë të punimit jam ndalur mbi poligaminë si kuptimi dhe zhvillimi i saj historik, se si poligamia ka qenë dhe është pjesë e disa feve dhe pjesë e disa ligjeve në disa shtete.

Në Islam kemi një perspektivë më të gjerë kur flasim për martesën ngase nuk e përkufizon martesën vetëm në mes një burri dhe gruas por ua lejoji të martohen me dy, tre dhe katër dhe atë duke u argumentuar nga ajete e Kuranit famëlartë ku thotë: "Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri apo me katër. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre) atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni. (En-Nisa, 3).

Më pas gjatë punimit të kësaj teme do silltet edhe një anketë nga vende të ndryshme

dhe pjesëtar të feve të ndryshme tek të cilët do ju parashtrahet disa pyetje dhe në bazë përgjigjeve të tyre do marrim një pasqyrë më reale për atë se çka njerëzit mendojnë për poligaminë.

Po ashtu në poligami ka edhe kushte të cilat duhet të plotësohen për të qenë e vlefshme ajo, por edhe brenda saj kemi ndalesa të cilat nuk guxojmë ti kalojmë apo ti thyejmë.

Këto janë vetëm elementet themelore që janë shtjelluar në këtë punim.

Lënda e hulumtimit

Lënda e këtij hulumtimi është martesë me më shumë se një bashkëshorte e cila njihet si poligami. Lirisht mund të thuhet se që nga fillimi i shoqërisë njerëzore martesë paraqet themelin e shoqërisë. Si një koncept juridik martesë trajtohet si qeliza e çdo shoqërie dhe një nga agjende kryesore juridike. Siç thekson edhe sociologu i njohur Giddens "Studimi i familjes dhe martesës përbën një nga fushat më të rëndësishme të sociologjisë, dukë mos e mënjanuar as atë juridik. Çdo njeri në të gjitha shoqëritë rritet në një mjedis familjar dhe në çdo shoqëri shumica dërrmuese e të rriturve janë të martuar ose kanë qenë të tillë". Ligji për Familjen, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nenin 6 e përcakton martesën si "Martesë është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë." Por poligamia është temë e cila nuk trajtohet aq shumë në shtetin tonë dhe prandaj si hulumtim është shumë interesant se si është e lejuar monogamia kurse nga ana tjetër nuk është lejuar poligamia. Në Islam kemi një perspektivë më të gjerë dhe atë duke u nisur nga ajete e Kuranit famëlartë ku thotë: "Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; më dy, tri e me katra. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre) atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robërshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni. (En-Nisa, 3).

Gjatë këtij studimi do të sqaroj rendësinë se pse Islami e ka lejuar poligaminë dhe atë duke sjellë fakte nga burime të ndryshme por duke përmbledhur edhe fakte nga popujt e tjerë të

cilët e praktikonin poligaminë edhe pse nuk ishin - janë pjesëtarë të Islamit.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për pozicionin e poligamisë, do të analizoj dhe studioj edhe zhvillimin historik të poligamisë që nga fillimet e tij e deri më sot.

Hulumtimi i këtij lloji na bën të mundshme që të kemi një pasqyrë më reale të asaj që kemi dhe që mund të bëhet

Qëllimet e hulumtimit

Punimi jonë ka karakter hulumtues. Pra, ne kemi hulumtuar argumentet, dëshmitë, faktet dhe përvojat të cilat, e mbështesin hipotezën kryesore lidhur me poligamia.

Si qëllim kryesor i një hulumtimi të tillë është studimi dhe analizimi i normave juridike në RMV, e cila martesën e tillë e ka ndaluar duke e kufizuar martesën vetëm me një grua. Me qëllim të kuptimit dhe njohjes më të mirë të poligamisë ka qenë e nevojshme që të definohet poligamia, roli i saj në shoqëri, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve në raste të poligamisë. Koha dhe metoda se kur do ishte më e arsyeshme një lloj martese e tillë.

Qëllim tjetër i këtij hulumtimi ka qenë që të studioj poligaminë dhe ndikimin e saj në familje, shoqëri por edhe në ligjin për familjen. Ngase martesa me ma shumë se një grua më saktësisht martesa deri me 4 gra është e lejuar në të drejtën islame për mashkullin ndërsa një gjë e tillë ju ndalohet gjinisë femërore

Realizimi i qëllimit të këtij punimi është mundësuar përmes shfrytëzimit të metodave të ndryshme si ato: normative, dogmatike, sociologjike, historike dhe metodave të tjera.

Hipotezat

1. Poligamia roli dhe ndikimi i saj në jetën familjare ?
2. A do ishte poligamia zgjidhje për mbylljen e shtëpive publike?
3. Me rast të poligamisë a janë të barabarta të drejtat e grave në një kurorëzim apo ndonjëra ka epërsi mbi tjerat ?
4. A është në rregull nëse ligjvënësi në RMV parasheh një nene të atillë për lejimin e poligamisë?
- 5 A është poligamia zgjidhje për natalitetin e madhe të gjinisë femërore?

6. Poligami a është shfrenim seksual apo mbrojtje e nderit ?

7. A do të thotë se lejimi i poligamisë nënkupton edhe obligimin e saj ose ka kohë kur do jetë me e përshtatshme praktika e saj?

Metodologjia e hulumtimit

Me qëllim të vërtetimit të hipotezave të përmendura më lartë dhe të konkluzioneve që janë nxjerr në përfundim të punimit, janë shfrytëzuar disa metoda me të cilat janë realizuar qëllimet e theksuara në këtë punim. Nëpërmjet këtyre metodave janë analizuar rregullat juridike të vendit por edhe ata Islame, dhe janë nxjerrur ngjashmëritë dhe dallimet nga analiza e detajuar si në Republikën e Maqedonisë së Veriut poashtu edhe në shtetet tjera tek të cilat praktikohet poligamia. Po ashtu nëpërmjet këtyre metodave në punimin tim kemi futur edhe disa të dhëna të cilat do të ndihmojnë që të shohim se si është gjendja sot dhe si ka qene më parë.

1. METODËN HISTORIKE: si metodë e pashmangshme, e cila në këtë punim është përdorur gjatë analizave dhe studimit të poligamisë që nga kohërat më të hershme e deri në ditët e sotshme.

2. METODA KRAHASUESE, si metodë e hulumtimit e cila është përdorur për të krahasuar në mes dy ligjeve të ndryshme në një kohë apo në kohë të ndryshme.

3. METODËN E DEDUKSIONIT DHE INDUKSIONIT: përdoret me qëllim që nëpërmjet këtyre metodave kemi arritur deri në konstatime të sakta. Pra, me anë të kësaj metode, nga konstatime të përgjithshme do të mundem të arrij në konstatime konkrete. Përveç metodës së deduksionit është përdorur edhe metoda analoge e saj, metodën e induksionit nëpërmjet së cilës nga konstatime konkrete është nxjerr konstatime të përgjithshme.

4. METODËN DESKRIPTIVE – PËRSHKRUESE: deskriptive-përshkruese: ku janë përshkruar ajete dhe hadithe për poligamin.

5. METODA E ANALIZËS SË PËRMBAJTJES: të materialeve dhe literaturave tjera të ndryshme, të vendit dhe të huaja rreth poligamisë

RËNDËSIA E PUNIMIT

Rëndësia e studimit të poligamisë është rezultat i një pune kërkimore dhe praktike për të identifikuar çështjen e poligamisë në të drejtën Islame dhe shtetin tonë, duke e krahasuar edhe me disa shtete të tjera, duke i njohur shkaqet për vendosjen e një rregulli të këtillë, sa është ai lloj martese në ditën e sodit praktikues etj.

Fokusim i veçantë në hartimin e këtij punimi do të jetë mundësia për të sqaruar pse poligamia do ishte më e arsyeshme për tu praktikuar dhe me siguri do na largojnë nga një numër i madh probleme siç janë shtëpitë publike, fëmijët jashtëmartesor, etj.

KAPITULLI I

1. MARTESA

1.1. Përkufizimi i martesës

Me martesë në të drejtën pozitive nënkuptojmë: një bashkësi jetësore e rregulluar me ligj mes një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.¹

Sipas juristëve islamë, me martesë nënkuptohet: “kontrata martesore e arritur në mes burrit dhe gruas me ç’rast fitojnë të drejtën ligjore të jetojnë në marrëdhënie intime.”² duke u bazuar në ajetin kur’anor: “Dhe martoni të pamartuarit, robërit dhe robëreshat tuaja, që janë të ndershme e të ndershëm....”³.

Me lidhjen e kontratës në mes mashkullit dhe femrës, atyre u lejohej veprimet të cilat i kanë pasur të ndaluara para se të hyjnë në martesë, qëllimi i martesës është formimi i një lidhjeje të ngushtë në mes bashkëshortëve duke krijuar harmoni në mes tyre, duke i plotësuar nevojat e tyre shpirtërore dhe fizike.

Martesa është veprim i të gjithë Profetëve. Muhammedi a.s. ka thënë: "O djelmossa! Ai që do të jetë në gjendje të gjejë person gjegjës për martesë, le të martohet sepse ajo do t'ia ruajë sytë nga harami dhe do ta mbrojë nga epshi. Nëse s'ka mundësi, le të agjërojë, sepse agjërimi do ta mbrojë nga gjynahet."⁴ Gjithashtu ka thënë: "Femra martohet për katër cilësi: Për shkak të pasurisë së saj, për shkak të prejardhjes familjare, për shkak të bukurisë dhe për shkak të fesë. Jepi përparësi fesë, që të gjesh qetësi."⁵ Nëse i marrim këto dy thënie të profetit shohim se martesë nuk përmban vetëm një numër të madh detyrash në mes çiftit, por ata

¹ Ligji për familje neni 6, Gazeta zyrtare e RMV nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14 и 104/15,

² Džananovič, Ibrahim, “Islamsko bračno pravo”, Gazi Husrevbegova Medresa, Sarajevo, 1985, fq.5

³ Sure En - Nur, ajeti 32, fq. 487 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

⁴ Prkth. Mr. Elez Ismaili, Hadithe të zgjedhura, fq. 404 nr.1955, Tetov 2014

⁵ Prkth. Jusuf Zimeri - Irfan Abazi – Taxhedin Bislimi – Fahrudin Ebibi - Suneni i Ebu Davudit vëll. II, Libri mbi martesën fq. 387 nr.2047 Furkan ISM – Shkup 2015

gjejnë edhe lumturin e qetësinë në mes tyre dhe në të njëjtën kohë ajo mbron njëri-tjetrin nga amoraliteti dhe gjërat e shfrenuara.

Në momentit e lidhjes së martesës në mes bashkëshortëve lindin të drejtat dhe obligimet konform qëllimit (funsioneve) të vetë martesës duke filluar nga mirëkuptimi dhe respekti i ndërsjellët, drejtësia, shumimi apo shtimi i familjes, çështjet pasurore, pronësia, edukimi i fëmijëve etj.

Supozohet se në mes të së drejtës pozitive dhe asaj islame ka një dallim të madh, por në esencë të dy të drejtat, respektivisht ligjet apo rregullat mbi familjen konsistojnë në qëllime të përbashkëta në funksion të martesës, siç janë: mbrojtja e shoqërisë, krijimi i familjes, ndarja e të drejtave dhe obligimeve, qetësia, harmonia, lumturia etj. Edhe pse në shikim të parë, në mes ligjit pozitiv dhe atij islam duket që ka një dallim në mes tyre, në realitet që të dy ligjet kanë për qëllim mbrojtjen e shoqërisë, krijimin e familjes dhe ndarjen e obligimit nëpërmjet së cilës do të arrijnë sa më lehtë në jetën e tyre bashkëshortore, qetësinë, harmoninë, lumturinë, do të plotësojnë njëri-tjetrin dhe do jenë dy trupa të ndarë por që e plotësojnë njëri-tjetrin.

Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Kurorëzimi (martesa) është prej sunnetit tim. Ai që nuk vepron sipas sunetit tim, nuk është nga unë.”⁶ - kjo na jep të kuptojmë që edhe martesa është nga veprimet profetike dhe e pëlqyer, që të veprohet në të njëjtën metodë, qëllimi i thënies së profetit ka qenë që të praktikohet duke vendosur kontrata martesore dhe i respektuar ata siç na ka mësuar vetë profeti.

1.2. Dispozitat islame

Në Islam, dispozitat që e rregullojnë jetën e njeriut janë: Kurani, Sunneti, Ixhmaja dhe Kijasi .

Kurani është fjala e All-llahut dhe mrekulli, e zbritur Muhammedit a.s. me shprehje (fjalë) arabe, i transmetuar deri te ne nëpërmes tevaturit (rrugë e besuar) leximi i të cilit është adhurim, i shkruar në Mus’haf, fillon me suren El- Fatiha dhe mbaron me suren En - Nas⁷.

⁶Ibn Maxhe vëllimi 1 fq 592 nr. 1847

⁷Taxhedin Bislimi – Hyrje në shkencën e Usulu – Fikhut fq. 56, Shkup 2018

Sunnet është çdo fjalë vepër dhe pëlqim i cili është transmetuar nga i dërguari i Allahut.⁸

Ixhmaja (Konsensusi) është dakordimi i muxhtehidëve (dijetarëve të fushës islame) të një kohe, nga populli i Muhammedit për një çështje legjitime.⁹

Kijas (Analogji) është krahasimi i një çështjeje për të cilën sheriati nuk ka dispozitë, me një çështje për dispozitën e së cilës ekziston argument, për shkak se të dy çështjet janë të barabarta në motivin e dispozitës.¹⁰

Këto janë dispozitat Islame me të cilat Bota Islame i nxjerr rregullat dhe ligjet se si duhet të jetojë, si duhet të sillet në martesë, cilat janë të drejtat e tij? etj..

Duke qenë se temën që mundohemi ta shtjellojmë ka të bëjë me martesën këtu do cekim edhe llojet e martesës të cilat kanë lindur varësisht prej rasteve të cilat janë paraqitur, situatave të krijuara dhe mund të jenë: martesë sunnet, farz, vaxhib, haram dhe mekruh, të gjitha këto do t'i trajtojmë në vete me sqarim rreth asaj se çka nënkuptohet me të dhe kur veprohet një lloj martese e tillë.

Martesa Sunnet (traditë) - Me fjalën sunnet nënkuptohet çdo veprim të cilin e ka bërë ose ka urdhëruar për të bëhet ose e ka pëlqyer veprimin e dikujt tjetër Muhammedi a.s. dhe kështu ka mbetur traditë veprimi. Në këtë rast, me martesën sunnet nënkuptojmë kur personi i plotëson kushtet për martesë dhe është në gjendje për t'u mbrojtur prej amoralitetit, Profeti, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Martohuni, shtohuni se me të vërtetë unë do krenohem me shtimin tuaj ndaj popujve tjerë (Ditën e Gjykimit)¹¹.

Martesa Farz (detyrueshme) -Me fjalën Farz nënkuptojmë çdo urdhër të prerë për veprimin e tij nga Zoti fuqiplotë ndërsa me martesën farz nënkuptojmë kur një person i plotëson kushtet për martesë dhe nuk është në gjendje të mbrohet nga amoraliteti atëherë martesa për të është e detyrueshme me qëllim të mbrojtjes së nderit të tij.

⁸Taxhedin Bislimi – Hyrje në shkencën e Usulu – Fikhut fq. 88, Shkup 2018

⁹Taxhedin Bislimi – Hyrje në shkencën e Usulu – Fikhut fq. 187, Shkup 2018

¹⁰Taxhedin Bislimi – Hyrje në shkencën e Usulu – Fikhut fq. 197, Shkup 2018

¹¹Ibn Maxhe vëllimi 1 fq. 592 nr. 1846

Martesa Vaxhib (e domosdoshme) - Me fjalën vaxhib nënkuptojmë urdhër jo të prerë për një veprë, ku në rastin e martesës nënkuptojmë personi i cili i plotëson kushtet e martesës dhe që nuk është i sigurtë që pa martesë nuk do të mund të ruhet prej jetës amoralë.

Martesa Haram (e palejueshme, ndalueshme) - Martesa Haram apo e ndaluar është lloji i martesës ku personi qoftë i gjinisë femërore apo i gjinisë mashkullore nuk i plotëson kushtet për martesë. Martesa pa plotësimin e kushteve do të sjellte dëm te partneri tjetër, p.sh. martesa e të çmendurve.

Martesa Mekruh (e papëlqyer, urryer) - Martesa mekruh ose e urryer është kur personi është i pasigurt për kryerjen e obligimeve me të cilat e obligon martesa.

1.3. Urtësitë (funksionet) e martesës

a). Urtësia e parë është se me martesë formohet familja, me lidhjen e martesës arrihen edhe lidhje të ngushta ndërmjet dy familjeve, duke e pas parasysh këtë atëherë mund të themi se martesa dhe krijimi i familjes është hapi i parë prej ku fillon ndërtimi i personalitetit të një personit (fëmije) në shoqëri, këtu fillon t'i merr mësimet e para të edukatës, zhvillimit të tij psikofizik me të cilën shpresojmë në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshtë për të ardhmen.

Martesa luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë, prandaj nëse një i ri do të rritej në një atmosferë me urrejtje, zili, egoizëm më doemos atë edhe do ta reflekton në shoqëri po bile edhe do ta përcjellë në gjenerata e ardhshme, ndërsa nga ana tjetër nëse një fëmijë do të rritej në mes urtësisë, bujarisë, atëherë po të njëjta gjëra do t'i paraqes në mes të shoqërisë dhe do të kemi një shoqëri të shëndoshtë me norma të larta morale.

Martesa nuk është vetëm se një obligim fetar ose nevojë e jetës së përditshme por ajo ka një lidhje të ngushtë me jetën shoqërore, harmoninë dhe ndihmës reciproke, në ajetin Kuranor, Zoti thotë: “O ju njerëz, vërtet ne ju krijuam juve nga një mashkull dhe një femër, ju bëmë popuj e fise që të njiheni mes veti...”¹²”

¹²Sure el – Huxhurat ajeti 13, fq. 716 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

b). Urtësia e dytë është se martesë është edhe plotësues i dëshirave biopsikologjike të njeriut, p.sh. marrëdhëniet intime mes bashkëshortëve, gjë janë nevojë njerëzore, dhe mos plotësimi i këtyre nevojave shpesh njeriun e drejton drejt humnerës dhe shkatërrimit.

Urtësia tjetër e martesës është ndikimi i tij në pjesën shpirtërore e cila është e lidhur ngusht me nevojat fizike si dhe ato psikologjike. Në rast se nevojat biologjike nuk plotësohen, atëherë ato ndikojnë negativisht te spermatozoidet, kurse aspekti psikik në rast të mos plotësimin e kënaqësive epshore shpie në disa shqetësime dhe devijime. Verseti Kur'anor thotë: "Dhe nga faktet e madhërisë së Tij është që për të mirën tuaj ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."¹³

Kjo na jep të kuptojmë që kënaqësia e plotë mes dy personave të gjinive të kundërta mund të arrihet vetëm atëherë kur janë në martesë, pra kanë dashuri dhe mëshirë në mes veti. Nëse e marrim marrëdhëniet seksuale të cilat i kryen një person me një lavire, atëherë te ato kemi vetëm kryerje të nevojës fiziologjike, ngase lavirja ja paraqet vetëm trupin e jo edhe shpirtin, kurse në martesë të dy kanë dashuri dhe mëshirë në mes veti dhe kjo i bën që të arrijnë kënaqësinë e plotë fizike dhe shpirtërore.

c). Urtësia e tretë është se martesë të mbron prej sëmundjeve të ndryshme të cilat janë të përhapura në botë, të cilat paraqiten si pasojë e amoralitetit, si p.sh. SIDA, triperi, silifisti etj. Shtetet të cilat janë më të zhvilluara janë munduar me metoda të ndryshme që të gjejnë një metodë për mbrojtje nga këto sëmundje, sa që vendosën edhe kujdesie ma të madhe ndaj shtëpive publike, por përsëri nuk arritën që të mbrohen nga sëmundjet. Islami dhe ligjet e tij e mbrojnë njeriun duke e ndaluar nga amoraliteti dhe duke i dhënë rëndësi familjes, duke e ndaluar që mos t'i afrohem amoraliteti, ngase ai është vepër e shëmtuar dhe rrugë e keqe e cila le pasoja të mëdha pas vetes, dhe nga ana tjetër na i bën me dije se njeriu u krijua nga

¹³Sure Er-Rrûm, ajeti 21, fq. 558 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

dheu, pastaj nga një pik uji, e pastaj i bëri çifte që të bashkëjetojnë. Muhammedi, paqja qoftë mbi të, ka thënë: “Kjo botë është kënaqësi, kënaqësia më e mirë është gruaja e mirë.”¹⁴

d). Urtësia e katër është se me martesë bëhet shtimi i njerëzimit në mënyrë legjitime, prandaj me lindjen e fëmijës dalin në pah dy gjëra: plotësohet dëshira e njeriut për të lënë trashëgimtarë, i cili do të trashëgojë gjitha frytet që i ka lënë paraardhësi i tij, dhe e dyta është se me martesë ruhet edhe lloji i gjinisë njerëzore, ngase njeriu është mëkëmbësi, rregulluesi, mirëmbajtësi në tokë.

Përpos këtyre urtësive të cilat i kemi përmendur më lartë ekzistojnë edhe shumë urtësi të tjera të cilat njeriu mund t’i fitojë vetëm me martesë dhe në jetën bashkëshortore.

Martesa është princip islam që plotësisht përputhet me rendin jetësor dhe me esencën e natyrshmërisë së njeriut me nevojat dhe kërkesat e tij, qofshin ato psikike-shpirtërore, fiziologjike etj..

Islami martesën e konsideron se është plotësim i imanit, ndihmë nga Zoti, mbrojtje nga amoraliteti, zbukurim i dy gjinive etj.

Mund të thuhet se sikur njerëzit t’i përkujtonin bukuritë, urtësitë dhe dobitë që vijnë me martesën, me siguri nuk do kishim këta sëmundjet që i kemi të përhapura në mesin tonë si shkak i mos martesës, duke e ditur që me të, pra me martesën, do vinte edhe një bagazh aq i madhe i detyrave, por edhe i mirësive, sepse të martuarve do t’u bënte që të jenë në një shkallë më të lartë nga ajo që kanë qenë deri më tani, si persona të pamartuar, do jenë ata që do vazhdojnë zinxhirin e njerëzimit me atë që është në përputhshmëri me natyrën njerëzore dhe rregullat njerëzore.

¹⁴Tergib ve Tehrib vëll. III fq.41

1.4. Ndarja e martesës në të drejtën Islame

Në jurisprudencën Islame martesën e ndajmë si martesë monogame dhe poligame të cilat janë të pranuar dhe praktike në mesin e myslimaneve dhe në shtetet islame, kurse poliandria është martesë e cila është e ndaluar.

Martesa ndahet në:

Monogami - Fjala monogamia rrjedh nga greqishtja monos - vetëm dhe gamos – martesë, që do me thënë bashkëjetesa e një burri vetëm me një grua, si një formë e martesës. Po ashtu monogamia mund t'i referohet edhe në njërin prej këtyre përkufizimeve siç janë:

- Monogami sociale e cila ka për qëllim dy partnerët që jetojnë së bashku duke pasur marrëdhënie intime dhe duke i shfrytëzuar burimet themelore siç janë: banimi, ushqimi dhe paraja.¹⁵
- Monogami seksuale që i referohet dy personave që mbesin ekskluzivisht seksual me njëri-tjetrin dhe nuk kanë partner seksual të jashtëm.¹⁶
- Monogami gjenetike i drejtohet marrëdhënieve seksuale monogamie me prova gjenetike të aftësisë.¹⁷

Monogamia është forma më e vjetër e martesës, e cila rezulton në botën njerëzore që nga fillimi i saj, por janë shtuar dhe ndryshuar kushtet, dhe gjatë gjithë historisë ka vazhduar si e tillë. Mirëpo, një veprim i tillë ka qenë praktikues, pra martesa ka qenë pjesë e çdo populli, race apo feje, pa marrë parasysh periudhën kohore në të cilën ka jetuar ose kushtet ekonomike

¹⁵Reichard, Ulrich H 2003 Monogamy : past and present fq. 3

¹⁶ Reichard, Ulrich H 2003 Monogamy : past and present fq. 3

¹⁷ Reichard, Ulrich H 2003 Monogamy : past and present fq. 3

me të cilat janë ballafaquar. Në shtetet perëndimore dhe ato lindore, mund të shihet se në sistemet dhe ligjet e tyre kanë paraparë monogaminë si martesë ligjore dhe kanë përcaktuar kushte dhe rregulla se si duhet të arrihet deri te ajo, Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në ligjin për familje neni 6 thuhet: “Martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.”¹⁸

Poliandria - Poliandria rrjedh nga greqishtja poli – shumë dhe andria – njeri, ndërsa në definicionin e përgjithshëm nënkupton bashkimi i një femre me më shumë se një mashkull.

Veprimi i një lloje martese të këtillë është i ndaluar me të gjitha të drejtat njerëzore në çdo shtet dhe nuk lejojnë praktikën e kësaj martese, po ashtu edhe në të drejtën Islame është e ndaluar poliandria edhe ata nga shkaqet si në vijim:

1. Nëse një grua ka më shumë se një burrë me të cilin kryen marrëdhënie intime atëherë fëmija i cili lind në këtë rast mund t’i dihet vetëm nëna dhe jo babai, edhe pse shkenca dhe teknologjia kanë arritur që kohën moderne nëpërmjet testeve gjenetike të mundën t’i gjejnë që të dy prindërit, por në të kaluarën kur shkenca dhe teknologjia nuk ishin në këtë evoluim që janë sot nuk kishte mundësi të përcaktohej se cili është babai i fëmijës së lindur.

2. Në aspektin biologjik burri është më lehtë t’i kryej obligimet e veta si bashkëshort pavarësisht se sa gra ka në martesën e tij, kurse një grua që ka më shumë se një bashkëshort nuk mund t’i kryejë obligimet e saja si bashkëshorte ngase pëson ndryshime të shumta psikologjike dhe në sjellje gjatë fazave të ciklit menstrual.

3. Gruaja që ka marrëdhënie intime me më shumë burra ka mundësi të mëdha të fitojë sëmundje të shumta venerale ose sëmundje të tjera që transmetohen seksualisht, edhe nëse asnjëri prej burrave nuk ka marrëdhënie të tjera jashtëmartesore, kurse e njëjta nuk ndodh me burrin i cili ka më shumë se një grua.¹⁹

Ka edhe shkaqe të tjera të cilat ndikojnë për mos praktikën e kësaj martese e cila sjell parregullsi në shoqëri.

¹⁸ Ligji për familje neni 6, Gazeta zyrtare e RMV nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14 и 104/15

¹⁹Zakir Abdulkerim Naik – 20 most questions about Islam fq. 7 2005

Nuk duhet të harrojmë se edhe për shkak se shtetet e ndryshme kanë ndaluar një veprim të tillë pra poliandrinë, ka vende te të cilët praktikojnë poliandrinë si që është Luginë Tsum (Luginë e Lumturisë) në Himalaje ku poliandria është e zakonshme, këtë e zbuloi autori Titus Arnu në librin e tij Tsum. Ekspedita e Himalajeve në Luginën e Lumturisë.²⁰

Nëse i shohim këtë faktë dhe shumë të tjera do ta kuptojmë se në realitet ndalesa e poliandrisë ka të bëjë më shumë me virtyte të larta të cilat Islami ia dha gruas dhe e çmoi atë si një ndër krijesat e cila është e vlefshme më shumë se sa një diamant apo gur i çmuar.

²⁰<http://www.fakte.mk/fshati-ku-grate-kane-2-3-burra-kurse-vendi-quhet-lugina-e-lumturise-2/> e marrur me datë 23.11.2019

KAPITULLI II

2. POLIGAMIA

2.1. Përkufizimi i poligamisë

Poligamia është një term i cili që në kohët e më hershme është përdorur në shoqëri, disa për të arsyetuar veprimin e tillë, kurse të tjerët për ta kundërshtuar një martesë të tillë, por që të dy palët arrijnë që ta argumentojnë me argumentet që atyre ju pëlqen e jo ndoshta realitetin e kësaj martese.

Fjala poligami rrjedh nga greqishtja e cila ka për qëllim lidhjen e martesës me më shumë bashkëshorte, dhe si kuptim i tillë arrin të përcillet në shoqëri si martesë me më shumë gra, ku përcaktimi i numrit të saj nuk është bërë edhe në bazë të saj gjatë periudhave të ndryshme kohore kemi numra të ndryshëm në martesë.

Në Islam poligamia është martesa e një burri deri me 4 gra në një kurorë duke vendosur kushte dhe rregulla se si duhet të arrihet deri te ajo martesë poligamie dhe si duhet që të jetohet brenda asaj martese duke mos harruar se do ketë dobitë por edhe problematikat të cilat nuk i ka një martesë e zakonshme mes dy partnerëve në monogami.

Islami si fe është sistem universal për çdo kohë dhe për çdo vend, e cila ka zgjidhje për çdo problematikë të shoqërisë. Në të kaluarën ka pasur por edhe sot kemi njerëz të cilët fillojnë të merren me lidhje jashtëmartesore për arsye se bashkëshortja nuk mund të arrijë në kënaqësinë e tij të plotë, ose femra nuk është në gjendje t'i lind fëmijë dhe bashkëshorti e divorcon ose beqari nuk e marton për shkak sterilitetit, kemi raste kur bashkëshorti dëshiron të ketë një numër të madh të fëmijëve dhe bashkëshortja nuk dëshiron përpos një ose dy dhe kjo shkakton probleme ku në shumë raste rezultojnë me shkurorëzimin e tyre.

Islami e lejon poligaminë me qëllim që njerëzit t'u largohen problemeve të cilat mund të lindin në mes bashkëshortëve dhe parregullsive në jetën shoqërore, pra është fe që përputhet me instinktin, shqyrton realitetin dhe largohet nga çdo teprim i mundshëm që është në dëm të njeriut ose shoqërisë.

2.2. Historiku i Poligamisë

Sa i përket zhvillimit historik të poligamisë do të shohim se jo çdoherë kanë qenë fetë ato që kanë lejuar poligaminë, por edhe vetë natyra njerëzore ka bërë veprime të atilla apo thënë më mirë jo vetë Islami ka lejuar praktikën e saj, por e kundërta, Islami e kufizoi numrin e rave në një kurorë nga ajo që ishte me qindra e dhjetar në 4 gra. Këtu do të flasim nga të dhënave historike që nga shoqëritë antike e deri te ajo tek Islami.

I). *Mesopotamia e lashtë dhe Asirisë* - Në Mesopotaminë e lashtë dhe Asirisë jetonin dy familjet babilonase dhe asiriane të cilët ishin parimisht monogamie në martesat e tyre por në praktikën e tyre sunduesit në veçanti shpesh praktikonin poligaminë, në shoqëritë të Mesopotamisë familja bërthamore quhej shtëpi, e cila për t'u ndërtuar kërkonte martesën e një burri dhe gruaje. E nëse ajo nuk i siguronte pasardhës, ai mund të merrte një grua të dytë. Kodi i Hamurabit deklaronte se ai humb të drejtën për poligami nëse bashkëshortja e tij i jep atij një skllave.²¹

Tekstet e vjetra Asiriane i obligonin që burrat të presin dy apo tre vite që të merrte gruan tjetër por me kusht që gruaja e dytë do të konsiderohej si vajzë skllave. Pra si do qoftë kjo tregon për shoqëri të lashta apo për disa prej ku fillon civilizimi ndërsa është prej vendeve që ka praktikuar poligaminë në kushte të cilat ata i kanë paraparë.²²

II). *Egjiptin e Lashtë* - Mbretërit e lashta Egjiptiane lejonin që burrat të jenë të lirë në martesat e tyre me sa gra që të dëshirojnë, duke mos i kushtëzuar me asnjë detyrimi rreth tyre, dhe kjo vazhdoi për disa dekada derisa njëri prej mbretërve ishte betuar në dashurinë vetëm një gruaje dhe kishte arritur me karrierën e tij deri në suksesin më të lartë të tij dhe këtë e shprehu në mënyrë të hapur përpara popullit të tij, prej ku disa filluan që të mos e praktikonin martesën me shumë gra, por vetëm me një arsyetim që të ishin të suksesshëm, pastaj filluan që

²¹Cf. R. De Vaux, *Ancient Israel Its life and Institutions*, London 1980 fq. 24

²²Cf. R. De Vaux, *Ancient Israel Its life and Institutions*, London 1980 fq. 25

ti zgjedhin grat me status ma të lartë që të kenë sukses në karrierën e tij por edhe përskej kësaj atyre ju lejohej që të kenë të dashura të cilat do ishin vetëm të tija.²³

III). *Arabët para Islamit* - Poligamia është një çështje shume e diskutueshme edhe pse një pjesë e historianëve dhe mendimtarëve të kohës moderne gishtin e drejtojnë nga arabët të cilët e kanë pasur këtë praktikë para ardhjes së Islamit dhe se disa gjurma të tyre janë gjetur më pas edhe në Islam. Prof. Bernard Lewis, i njohur si ekspert perëndimor për historinë e Islamit, komenton për këtë: "Në përgjithësi, ardhja e Islamit solli një përmirësim të jashtëzakonshëm për pozitën e grave në Arabinë e hershme duke i dhënë atyre pasuri dhe të drejta të tjera, si dhe duke u dhënë mbrojtje ndaj trajtimit të keq që i bënin burrat apo pronarët e tyre. Vrasja e foshnjave femra, e sanksionuar ne Arabinë Pagane u bë e paligjshme me ardhjen e Islamit."²⁴ Po ashtu edhe Karen Armstrong, bën këtë koment: "Duhet të rikujtojmë sesi ka qenë jeta për gratë në periudhën para Islamit, kur vrasja e foshnjave vajza ishte normë dhe kur gruaja nuk kishte asnjë të drejtë fare. Gratë, ashtu si skllëvërit. trajtoheshin me inferioritet, e ato nuk kishin ekzistencë ligjore. Në një botë të tillë primitive, ajo që arriti të bëjë Muhamedi për gratë ishte e jashtëzakonshme. Vetëm ideja e thjeshtë se gruaja mund të bëhej dëshmitare apo se ajo mund të trashëgonte çdo gjë ishte habitëse, magjepse"²⁵

Arabët në martesat e tyre kishin të drejtë për më shumë se një bashkëshorte, ku numri i tyre arrinte deri ne 10 sipas asaj që tregojnë shokët e profetit, po ashtu tregojnë se Giilan Thekafiu pranoi Islamit dhe ai ishte i martuar me 10 gra, prandaj erdhi te Muhammedi a.s. që ta pyesë rreth çështjes së martesës së tij, kurse profeti iu përgjigj: "Mbaj katër dhe lëshoi të tjerat!"²⁶.

Kishte prej atyre burrave të cilët ishin të pakënaqur me lindjen e fëmijëve të tyre, veçanërisht ishin të pakënaqur me vajza, prandaj për atë shkak ia besonte dikujt tjetër bashkëshorten e tij, i cili fëmijët i kishte të shëndoshtë dhe shpresonte që gruaja e tij po pat

²³Hilmi Ismaili & Fatmir Sejdiu– Historia e shtetit dhe e së drejtës I fq. 58 – 59, Prishtinë 2005

²⁴Bernard Lewis, The Middle East, Weidenfeld & Nicolson, fq. 210, London, 1995.

²⁵Karen Armstrong, Muhammad A Biography of The Prophet, fq. 191 Harper Collins Publisher, USA, 1992.

²⁶Muveta vëllimi II fq. 586 nr.76

marrëdhënie seksuale me të dhe mbetet shtatzëne do të ketë një fëmijë të shëndoshtë etj. Arabët nuk kishin ndonjë rregull se si duhet të kenë jetën martesore të tyre, për ishte më me rëndësi të kenë një numër të madhe të grave për plotësimin e dëshirave të tyre dhe shtimin e natalitetit të tyre në veçanti të djemve.

IV). *Shqiptarët në kanun të Lek Dukagjinit* - Deri në vitin 1929 kur te shqiptarët hyri në fuqi kodi civil i Amet Zogut, çështjet familjare i zgjidhnin me disa kode shumë të avancuara se si duhet të jenë të rregulluara, prandaj gjejmë nëpër troje të ndryshme praktika të ndryshme të kodeve ku në disa vende i kemi sipas përkatësive fetare të palëve, e në disa të tjera sipas traditave të vendit etj.

Por sipas disa hulumtimeve, si kod që e kanë zbatuar një numër ma i madh i shqiptarëve ka qenë Kanuni i Lek Dukagjinit.

Sipas kanunit martesa përshkruhet me këto fjalë në neni 28: Me u martue sipas kanunit do me thanë me u ba shpi, me ia shtue nji rob ma tepër sa për krah të punëve e sa për ti shtu fmit.²⁷

Duke pasur parasysh këtë nen të kanunit e vërtetojmë se me Kanun nuk ka qenë e parapamë martesa me më shumë se një grua, por në jetën e tyre të përditshme do të shohim se nga gojëdhënat ka pas edhe martesa ku një burrë ka pas 7 gra, dhe si i tillë ai ka pasur për detyrë vetëm të kujdeset për çiftin e tij dhe të kujdeset për bashkëshortet të cilat kanë punuar te arra dhe te shtëpia, ndërsa ky ka kuvendu dhe është krenuar se si i mban nën kontroll të gjitha ato gra.

V) *Poligamia tek Hindusët* - Sipas ligjit Indian vetëm myslimanët janë te lejuar të kenë më shumë se një grua. Pavarësisht nga të qenët ilegal për Hindusët, ata kanë gra me numër të shumëfishtë, më herët nuk kishte kufizim madje edhe tek burrat hinduis autoritativ, në numrin e grave te lejuara, sikurse mbreti Dashrat, babai i Ramës, kishte më shumë se një grua. Kërshna ose Krishna kishin disa gra. Historikisht, mbretërit merrnin herë pas here konkubina. Për

²⁷Kanuni i Lek Dukagjinit – Kim Mehmeti fq. 45 Logos -a – Shkup 2008

shembull, Perandori i Vijaynagara, Krishnadevaraya, kishte shumë gra. Dhe në vitin 1954 akti Martesor Hinduist bëhet legal apo i lejuar për Hinduset që të kenë më shumë se një grua. Dhe tani është ligji Indian ai që bën kufizimin e një Hindusi që të ketë më shumë se një grua dhe assesi nuk ishin skripturat Hinduse (librat e tyre të shenjta).²⁸

VI) *Poligamia te hebraenjtë* - Legjislacioni hebraik obligon çdo hebre për martesë si të domosdoshme me arsyetim të shtimit të natalitetit, ngase dihet se numri i tyre si popull është i vogël, kurse sa i përket poligamisë, hebrenjtë e lejojnë martesën e tillë por jo pa arsye. Poligamia është e lejuar në Judaizëm. Bazuar në ligjin e Telmudit, Abrahami ka pas tri gra, ndërsa Solomoni ka pas qindra gra apo më saktë kishte 700 gra të lira dhe 300 robëresha.²⁹

Kur erdhi Musai, alejhis-selam, si profet, e aprovoi poligaminë duke mos e përcaktuar numrin se sa gra i lejohet t'i ketë një burrë. Përcaktimin e numrit e bënë Benu Israilët (jehudët) në Kuds, edhe pse disa prej dijetarëve të tyre e ndaluan poligaminë, e disa e lejuan nëse gruaja është e sëmurë apo sterile.

Midis hebrenjve, fenomeni i poligamisë ka qenë mbizotërues që nga antikiteti. Vetëm njerëzit e suksesshëm mund të përballonin disa gra. Tivrati - shkrimi i hebrenjve përshkruan që të ketë një bashkëshorte të dytë nëse i pari ishte i zhveshur ose i dobët. Në shekullin XI, Rabini Meor Gershom (960 deri në 1030) vendosi një dekret 1000-vjeçar, i cili urdhëroi që të mos ketë më shumë se një grua dhe një ndalim për divorc pa pëlqimin e saj. Hebrenjtë modernë për kthimin e poligamisë për të korrigjuar situatën demografike në Izrael, sipas mendimit të tyre, periudha 1000-vjeçare ka mbaruar tashmë.³⁰

Arsyetimin e tyre për martesë poligamie e gjejnë në bazë neni 146 të Hajb ibn Shamuni në të cilin thuhet se nëse gruaja brenda 5 apo 10 viteve nuk mund që të lind, atëherë burri obligohet që ta shkurorëzojë ose të martojë edhe një tjetër nëse i lejojnë mundësit për poligami.

²⁸Zakir Abdul Kerim Naik – Përgjigje jomyslimanëve në pyetjet më të shpeshta për Islamin, fq. 18 Maj 2010

²⁹Sherif Abdel Azim – Gratë në Islam kundrejt grave në traditën judeo-kristiane; Miti & realiteti, fq.64 Shkodër, Korrik 1996

³⁰Zakir Abdul Kerim Naik – Përgjigje jomyslimanëve në pyetjet më të shpeshta për Islamin, fq. 17 Maj 2010

Hebrenjtë evropianë vazhduan ta praktikojnë poligaminë deri në shekullin XVI. Herenjtë orientale e praktikuan rregullisht poligaminë gjersa mbërritën në Izrael, ku ajo ndalohet nën ligjin civil. Komunitetet judaiste që jetojnë neper vende myslimane kanë vazhduar ta praktikojnë atë deri vonë në vitin 1950, kur një Krye rabin i Izraelit publikon një ndalës që të martohet me shume se një grua.³¹

VII) *Poligamia te Krishterët* - Poligamia është një praktikë tepër e lashtë, që gjendet në shumë shoqëri njerëzore. Bibla nuk e dënoi poligaminë, përkundrazi, Dhiata e Vjetër dhe shkrimet rabinike i referohen shpesh ligjshmërisë së poligamisë. Mbreti Solomon thuhet të ketë pas 700 gra e 300 konkubina (I Mbretërit, 11:3). Edhe mbreti David thuhet të ketë pas shumë gra e konkubina (II Samueli, 5:13).³²

Dhiata e Vjetër përmban në të vërtetë udhëzime se si të ndahet pasuria e një burri mes djemve të tij nga gra të ndryshme (Ligji i Përtërirë, 22:7).

I vetmi kufizim për poligaminë është të ndaluarit e marrjes për grua rivale motrën e bashkëshortes (Levitiku 18:18).

At Eugene Hillman në librin e tij të mprehtë *Poligamia e Rishqyrtuar*, "Askund në Dhiatën e Re nuk ka as edhe një urdhëresë eksplicite që martesë duhet të jetë monogame, apo çfarëdolloj urdhërese të hapur që ndalon poligaminë."³³ Përveç kësaj, Jezusi s'ka folur kurrë kundër poligamisë, megjithëse ajo praktikohet nga hebrenjtë e shoqërisë së tij.

At Hillman thekson faktin se Kisha në Romë e ndaloi poligaminë, që t'i vinte përshtat kulturës greko-romake (e cila parashtronte vetëm një grua të ligjshme, ndërkohë që toleronte bashkëjetesën dhe prostitucionin). Ai citon Shën Agustinin, "E vërteta është se në kohën tonë, duke ruajtur dhe vazhduar zakonet romak, marrja e një bashkëshorteje tjetër nuk lejohet më."³⁴

³¹Lesley Hazleton, *Izraeli Women: The Reality Behind the Myths* (New York: Simon and Schuster, 1977) fq 44 - 45

³²Sherif Abdel Azim – *Gratë në Islam kundrejt grave në traditën judeo-kristiane; Miti & realiteti*, fq.64 Shkodër, Korrik 1996

³³Eugene Hillman, *Poligamy Reconsidered: African PluralMarriage and the Christian Churches* (New York: Orbis Books, 1975) fq 140.

³⁴Eugene Hillman, *Poligamy Reconsidered: African PluralMarriage and the Christian Churches* (New York: Orbis Books, 1975) fq 17.

Nuk ka asnjë hap në Testamentin e Ri që ndalon shprehimisht poligaminë, përveç në rastin e peshkopëve dhe të dhjakëve. Kjo ishte mirëkuptimi i Etërve të hershëm të Kishës dhe për disa shekuj në epokën e krishterë.

Westermarck, është një autoriteti i njohur për historinë e martesave njerëzore, ai shprehet duke thënë se: "Në raste të ndryshme Luteri flet për poligaminë me një tolerancë të jashtëzakonshme. Nuk ishte e ndaluar nga Zoti: madje edhe Abrahami, i cili ishte një "i krishterë i përsosur", kishte dy gra. është e vërtetë që Zoti kishte lejuar martesa të tilla për disa burra të Testamentit të Vjetër vetëm në rrethana të veçanta, dhe nëse një i krishterë dëshironte të ndiqte shembullin e tyre, ai duhej të tregonte se rrethanat ishin të ngjashme në rastin e tij; por poligamia ishte padyshim e preferuese për divorc."³⁵

Në 1650, menjëherë pas Paqes së Westfalisë , kur popullsia ishte zvogëluar ndjeshëm nga lufta 30 vjet, Nremberg Kreistag miratoi rezolutën që nga atëherë e tutje çdo burri duhej të ishte lejuar të martohej me dy gra. Disa sekte të krishtera madje kanë mbështetur poligaminë me shumë zell. Më 1531 , Anabaptistët predikuan hapur në Münster se ai që dëshiron të jetë një i krishterë i vërtetë, duhet të ketë disa gra. Dhe Mormonët, siç dihet, e konsiderojnë poligaminë edhe një institucion hyjnor. "³⁶

Kishat afrikane dhe të krishterët afrikanë ua kujtojnë shpesh vëllezërve të tyre evropianë se ndalimi i poligamisë nga Kisha është traditë kulturore e jo udhëzim autentik kristian.³⁷

VIII) *Poligamia në Islam*

Martesa me një grua - martesa e parë e dy njerëzve të parë në rruzullin tokësor Ademit dhe Havës ishte monogamike e cila në realitet është edhe thelbësorë për Islamin gjegjësisht për myslimanët dhe si e tillë ka vendin e parë në çështjen e martesës, duke nisur nga ajeti kuranor:

³⁵Wastermarck, Edvard Alexander – The history of human marriage, New York; the allerton book bot. V vëll. III fq. 236

³⁶Hamude Abdulati – Struktura familjare në Islam, fq.112, logos –a, Shkup 1995

³⁷Sherif Abdel Azim – Gratë në Islam kundrejt grave në traditën judeo-kristiane; Miti & realiteti, fq.65 Shkodër, Korrik 1996

"Martoni të pamartuarit (e të pamartuarat) tuaja dhe skllavët (e skllavet) tuaja të ndershme. Nëse janë të varfër, Zoti do t'i begatojë nga dhuntitë e Tij ... " ³⁸

Martesa me dy gra – Ibrahim i a.s. ishte profeti i Zotit i cili u martua me dy gra, të cilit iu dha propozimi nga bashkëshortja e parë e tij që ishte sterile, që të lidhte kurorë me një grua të dytë që të ketë pasardhës.³⁹

Martesa me më shumë se një grua – Muhammedi a.s. ishte profeti i fundit i cili ishte i martuar me 11 gra por që të gjitha i kishte nga shkaqe të ndryshme, këtu do t'i cekim vetëm shkaqet e martesës së tij me 11 gra dhe atë siç janë: U martua me to që të jenë larg mundimeve dhe të lirë në praktikimin e fesë, që të ketë lidhje miqësie me njerëzit të cilët veç se e kishin pranuar Islamin, të jetë shembull për myslimanët se bukuria dhe pasuria nuk janë asgjë, t'ua mësonte praktikimin e urdhrave të Zotit. Zbutjen e armiqësisë me armiqtë, martesën me disa gra ishte shkak që shumica e njerëzve të fisit të saj të pranojnë Islamin etj.

Pra si që shohim më lartë që shkak i martesës së profetit nuk ka qenë përmbushja e dëshirave seksuale si që pretendojnë disa, gjithashtu të cekim këtu se profeti me një kurrorë ka pas 9 gra kurse dy prej tyre Hadixhja dhe Zejnebja e bija e Uzejmës kanë vdekur ma herët. Me të gjitha gratë profeti ishte martuar para se të zbresë ajeti Kuranor i sures En – Nisa ajeti 3 i cili i u shpallë në vitin e 8 të hixhrit apo tri vite para se të ndërrojë jetë profeti. Me zbritjen e këtij ajeti myslimanëve u bëri me dije se kanë të lejuar deri në 4 gra të kenë me një kurorë, kurse tash na lind pyetja pse ai mundi që t'i mbajë gjitha ata gra?

Përgjigjeje është te ajeti 53 i sures Ahzab ku thotë: "Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e All-llahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij pas (vdekjes së) tij. Këto janë te All-llahu mëkati madh"⁴⁰

Gratë e profetit për shkak të respektit dhe vlerës së tyre që gëzonin në shoqëri nga Zoti u është ndaluar martesa me njerëz të tjerë pas profetit po ashtu u bë edhe për shkak statusit që gëzonin si "Nëna të myslimanëve", pastaj profeti atë numër të grave që kishte ai e kishte të fiksuar ngase edhe sikur t'i vdiste ndonjëra ai nuk martonte më tjera por edhe sikur t'i vdisnin

³⁸Sure Nur ajeti 32 fq. përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

³⁹Amr Halid - Historitë e Profetëve fq. 180, Furkan Ism, Shkup

⁴⁰Sure Ahzab ajeti 53 fq. 586 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

të gjitha, ai nuk kishte të drejt t'i plotësonte ato, dhe atë duke u bazuar në ajetin Kuranor: “Prej tash e andej ty nuk të lejohen më gra (tjera) e as në vend të tyre të marrësh ndonjë tjetër, po edhe sikur të mahnitë bukuria e tyre.”⁴¹

Për ta treguar realitetin se profeti nuk ishte i dhënë pas epsheve është edhe vetë fakti se pa besimtarët arab i ofruan atij vajza të bukura të virgjëra dhe atyre që ishin të martuara që të zgjedh kë të dojë vetëm të tërhiqet prej thirrjes së tije në fenë Islame, por ai i refuzoi këtë ofertë. Muhammedi u martua në moshën 25 vjeçare dhe deri në moshën 50 vjeçare ishte i martuar vetëm me Hadixhen gruan e parë pa pasur ortake, kurse shkenca në ditët e sodit deklaroi se mosha prej 25 deri 50 vjeçar është mosha kur epshi është në kulminacion. Kjo dëshmonte se qëllimi i profetit me gra të tjera mbas moshës 50 vjeçare ka qenë strategji për bashkimin dhe forcimin e lidhjeve me fiset e tjera dhe me miqësinë me to.

2.3. Rregullimi i poligamisë në jurisprudencën islame

Në të drejtën Islame (Sheriatit) siç e kemi cekur edhe më herët në këtë punim janë katër burime, në bazë të të cilave është përpiluar jurisprudenca islame. Burimi primar apo kryesor është Kur’ani (shpallja hyjnore), burimi sekondar është Hadithi (porosia profetike), si dhe burimet terciare janë Ixhmaja (pajtueshmëria e plot juristëve islam për normat juridike) si dhe Kijasi (normat juridike në bazë të logjikës dhe analogjisë).

Kurani si burim i së drejtës

Kur’ani është përmbledhje dispozitash, i cili përmban, përveç tjerash edhe dispozita juridike, por pa hyrë në shqyrtim detaj të tyre. Në vijim do të sjellim ajetet kuranore me të cilën Krijuesi i gjithësisë e lejon martesën me më shumë se një grua:

- Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri e me katër. E nëse i frikoheni

⁴¹Sure Ahzab ajeti 52 fq. 586 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.⁴²

- Të pyesin ty që t'i udhëzosh për çështjen e grave. Thuaju: "Allahu ju udhëzon ju për to dhe për çfarë ju lexohet juve në Libër për çështjen e jetimeve të cilave ju nuk u jepni pjesën e detyruar (për mehrin – vlerë për martesën e tyre dhe trashëgimin), por që megjithatë, ju lakmoni të martoheni me to."⁴³

Hadithi si burim i së drejtës

Hadithi është burimi i dytë i së drejtës islame, pas burimit kryesor, Kur'anit. Profeti Muhamedi a.s i ka elaboruar më në detaje dispozitat e përgjithshme që kanë të bëjnë me lëmenjtë e ndryshme shoqërore. Veprimet dhe rekomandimet e t'ia për çështje të caktuara kanë shërbyer si burim sekondar i hartimit të së drejtës Islame (Sheriatit).

- Kajs ibn Harithi ka thënë: Praova Islamin e unë kisha tetë gra, pastaj erdha te Pejgamberi a.s. e ai në atë rast më tha: "Zgjidhi katër prej tyre." ⁴⁴
- Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të] transmeton se Muhammedi [alejhissalam] ka thënë: "Kush i ka dy gra dhe nuk sillet në mënyrë të barabartë ndaj të dyjave, do të vijë në Ditën e Gjykimit me një anë e cila do të jetë e lakuar!⁴⁵
- Ebu Hurejra r.a. tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nuk është e lejueshme për një grua që të kërkojë shkurorëzimin e motrës së saj myslimane (e gruas së

⁴²Surja en – Nisa ajeti 3 fq. 127 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

⁴³Surja en – Nisa ajeti 127 fq. 150 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

⁴⁴Tirmidhi vëll. III fq. 436 nr.1129

⁴⁵Termidhiu vëll. iii fq. 447 nr. 1141

parë të burrit të saj të ardhshëm), me qëllimin që ajo të ketë gjithçka për vete, pasi ajo do të ketë vetëm aq sa Allahu ka paracaktuar për të."⁴⁶

- Neufel ibn Muavije se ka thënë: “Kur kam pranuar Islamin kam qenë i martuar me pesë gra dhe e kam pyetur Pejgamberin salallahu alejhi ue selem dhe më tha: “Shkurorëzoje njëren dhe mbaj katër.”⁴⁷

Mendimet e dijetarëve

Është e udhës që të përmendim këtu fjalët e disa prej mendimtarëve mysliman dhe ato perëndimorë të cilët thërrasin në poligami dhe atë e shohin si shpëtim të vetëm për zgjidhjen e disa problemeve në shoqëritë e tyre:

- Ibën Xherir et-Taberi dhe Shevkani shënojnë edhe këtë: Disa kanë thënë se domethënia e këtij ajeti (ka për qëllim ajetin numër 3 të sures En- Nisa) është: “Sikur që frikësoheni nga pamundësia e plotësimeve të të drejtave ndaj bonjakeve, në të njëjtën mënyrë duhet të frikoheni nga prostitucioni me gratë. Mos bëni prostitucion, por nga gratë që u janë të lejuara merrni nga dy, tri ose katër.”⁴⁸
- Filozofi Gustave Le Bon, në librin e tij “Civilizimi arab” thotë: “Poligamia e ruan shoqërinë nga tragjedi të shumta dhe nga rreziku i të pasurit dashnore dhe fëmijë pa prind”⁴⁹

⁴⁶Sahihi Buhari, përk. Feti Mehdiu, vëll. X fq. 455 nr. 5152, Prishtinë 2014

⁴⁷Tefsirit të Kurtubiut vëll. 5 fq. 17

⁴⁸Fethu'l-kadir. Shevkani fq. 123

⁴⁹Pozita e gruas në Islam – Dr. Abd ar – Rahman bin Abd Al- Kareem Ash- Sheha fq. 69

- Annie Besant, në librin e saj “Fetë e njohura në Indi” faqe 139 thotë: “Në Dhjatën e Vjetër (Tevrat) e gjen se i sinqerti, ai që zemra e tij ishte në përputhje më dëshirën e Zotit, kishte më shumë se një grua. Gjithashtu edhe Dhjata e Re (Inxhili) nuk e ndalon poligaminë, përveç për peshkopët dhe sakrestanët të cilëve nuk u lejohet më shumë se një grua. Poligaminë e gjen edhe në librat e vjetra indiane. Si është e mundur që perëndimi ta luftojë poligaminë e kufizuar, kur prostitucioni është i shpërndarë shumë në shoqëritë e tyre. Nëse mediton rreth situatës në ato shoqëri do të gjesh se janë vetëm një pakicë e njerëzve të pastër që mjaftohen vetëm me gratë e tyre legjitime. Prandaj, nuk mund të thuhet se anëtarët e një shoqërie e respektojnë monogaminë, kur krahas grave legjitime kanë edhe dashnore tjera të fshehta. Nëse i matim gjërat me peshoren e drejtësisë, do të shohim se poligamia islame, e cila i ruan, i mbron, i ushqen dhe i veshmbathë gratë është më e mirë se sa prostitucioni perëndimor, i cili ia lejon burrit që të ketë një femër të cilën do ta përdor vetëm për shfryrje të epshit të tij, e më pastaj ta lë atë kudo në rrugë. Të dyja janë të këqija(140) , mirëpo nuk bën që një i krishterë.⁵⁰

2.4. Shkaqet e poligamisë

Poligamia në Islam nuk shihet si urdhër i prerë prej Krijuesit për praktikimin e saj në jetën e përditshme ngase edhe nuk është urdhër për tu praktikuar si martesë monogamie, por është një lejim apo pëlqim i Krijuesit që krijesat e tij njerëzore më saktësisht ajo mashkullore ju lejohet martesë me më shumë se një grua por duke pasur parasysh shkaqet të cilat arrijnë deri në lejimin e një martesë poligamie.

Shkaqet e lejitimit të poligamisë munden me qenë:

⁵⁰Pozita e gruas në Islam – Dr. Abd ar – Rahman bin Abd Al- Kareem Ash- Sheha fq. 69

1. Shkaqet e përgjithshme të poligamisë.
 - Shtimi i grave dhe pakësimi i burrave.
 - Ekzistimi i të vejave

2. Shkaqet që ndërlidhen me dy bashkëshortëve
 - Shtimi i pasardhësve.
 - Dhënia pas epsheve.
 - Steriliteti i gruas.
 - Mosmarrëveshja në mes dy bashkëshortëve.

2.4.1 Shkaqet e përgjithshme të poligamisë.

Shtimi i grave dhe pakësimi i burrave - Nëse marrim statistika të ndryshme nëpër kohëra të ndryshme shekuj e vite do të shohim se numri i grave ka qenë më i madhe se sa ai i burrave, sa për ilustrim Shtete e Bashkuara të Amerikës kishin 2 milion ma shumë gra se burra, Gjermania kishte 3 milion më shumë gra se burra, Egjipti 125 mijë ma shumë gra se burra këto ishin të dhëna sipas gazetës Egjiptiane El – Ahram të datës 16.11.1965,⁵¹ kurse sipas portalit zëri i Amerikës të botuar në Mars të vitit 2011 thuhet se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për nga numri i popullsisë gratë ua kalojnë burrave me 4 milion.⁵² Vetëm Nju Jorku ka një milion femra me shumë krahasuar me numrin e meshkujve, dhe ç’është e vërteta, një e treta e popullatës se meshkujve të Nju Jorkut (New York) e përbëjnë homoseksualët, SHBA-të në tërësi numërojnë më shumë se njëzet e pesë milion homoseksual, kjo nënkupton faktin se këto krijesa nuk shprehin dëshirë të martohen me femra. Numri i vajzave në Britaninë e Madhe ia kalon

⁵¹E drejta familjare në Islam – Fahrudin Ebibi/ Irfan Abazi/ Taxhedin Bislimi/ Jusuf Zimeri fq. 92 - Shkup 2004

⁵²<https://www.zeriamerikes.com/a/popullsia-ne-shtetet-e-bashkuara-arrin-ne-mbi-308-milion-banore/458099.html> e marrur me datë 26.11.2019.

numrit të meshkujve me shifër prej katër milion. Gjermania kap shifrën në pesë milion femra me shumë se sa meshkuj. Rusia ka nëntë milion femra me shumë se sa meshkuj. Vetëm Krijuesi është në dijeni rreth numrit më të madh të femrave në tërë botën.⁵³

Popullsia e Shqipërisë në 1 janar 2019 është 2.862.427 persona, me rënie prej 0,28 % gjatë vitit 2018. Gjatë këtij viti, numri i grave në Shqipëri ka vijuar të rritet, me një normë pozitive rritjeje prej 0,08 %, ndërsa popullsia e burrave ka rënë me normë 0,6 %. Në vitin 2018, gratë përbëjnë 50,1 % të popullsisë gjithsej.⁵⁴

Në Kosovë me një popullsi afër 1 milion banor raporti gjinorë në lindje apo koeficienti i maskulinitetit për vitin 2015 është 102 meshkuj për 100 femra dhe nuk ka ndryshime të mëdha sipas viteve.⁵⁵

Në Republikën e Maqedonisë Veriore në vitin 2016 në bazë të statistikave të entit shtetërorë gjithsej popullsi kemi pasur 2.073.702 prej të cilëve të gjinisë mashkullore kanë qenë 1.038.613 kurse të gjinisë femërore kanë qenë 1.035.089 që i bie që për 3524 persona të gjinisë mashkullore kanë qenë në epërsi ndaj gjinisë femërore i cili për dallim prej viti 2015 ku popullata e Maqedonisë së Veriut ka numëruar 2.070.226 prej të cilëve të gjinisë mashkullore kanë qenë 1.037.060 kurse të gjinisë femërore kanë qenë 1.033.166 që i bie që për 3894 persona të gjinisë mashkullore kanë qenë në epërsi ndaj gjinisë femërore. Nëse i bëjmë një krahasim të viti 2015 dhe 2016 atëherë do të shohim se numri i gjinisë femërore është shtuar për 1923 vajza, kurse numërim i gjinisë mashkullore ka një rënie prej 1553 djem që i bie që dallimi në mesë këtyre dy gjinive për çdo vite hasë në ndryshim dhe nëse do kishte një statistikë të viti 2019 me një vazhdimësi të tillë do të shihnim që numri i vajzave për dallim të djemve do ishte në rritje dhe do të kishte një dallim prej 6534 vajzave më shumë se djem (supozim i imi).

⁵³<https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=107> e marrur me datë 27.11.2019

⁵⁴Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2019 – INSTAT fq. 16

⁵⁵GRATË DHE BURRAT NË KOSOVË 2014-2015 - (ASK) fq. 14

Duke pasur parasysh këta numra të lartë përmendura e shohim se në disa shtete kemi një numër të madh të femrave në epërsi të meshkujve kurse në disa të tjera ose janë në barazi ose janë në rritje të numrave në favor të gjinisë femërore.

Ekzistimi i të vejave – Thotë All-llahu xh.sh në ajetin Kuranor ;“Paraqitja juaj për martesë ndaj grave (që kanë kryer afatin e tyre), në mënyrë të tërthortë, ose mbajtja fshehtë në veten tuaj, nuk është mëkat për ju. All-llahu e di se ju do t'ua përmendni atyre (dëshirën për martesë), por kurrresi mos u premtoni atyre fshehtazi (diç tjetër), përpos t'u thoni fjalë të lejuara. Dhe mos vendosni lidhjen e kurorës derisa të përfundojë afati i caktuar. Ta dini se All-llahu e di çka fshehni në vete, pra kini frikë prej Atij, dhe dijeni se All-llahu falë shumë, është i butë.”⁵⁶ Ekzistimi i të vejave mund të jetë si pasojë e luftërave, katastrofave natyrore ku bashkëshortëve ju vdesin burrat. Shumë prej myslimanëve të parë martoheshin me ato gra të veja të cilave burrat u ishin vrarë në luftë dhe kështu kujdeseshin për ato dhe për fëmijët e saj duke i larguar nga rruga e keqe dhe duke shpenzuar për edukimin e tyre. Shembulli më i afërt për të forcuar këtë është situata në Gjermani pas Luftës së II Botërore. Në fakt, numri i burrave u ul ndjeshëm në krahasim me gratë dhe tre vajza i takonin një të riut. Më 1949, njerëzit e Bonit iu drejtuan autoriteteve kompetente dhe kërkuan që kushtetuta të lejonte që të ketë martesë poligame. Qeveria gjermane kërkoi gjithashtu informacion nga Rektorati i Universitetit Az-har në lidhje me rendin e poligamisë së Islamit në mënyrë që të korigjonte këtë situatë si rezultat i luftës. Më vonë, një delegacion i shkencëtarëve gjermanë u takua me Rektorin e Az-har. Ndërkohë disa myslimane gra gjermane, morën pjesë në programet e Az-har, për të mësuar rreth dispozitave të Islamit për gratë, veçanërisht rreth poligamisë. Në këto raste i vetmi shpëtim për mbrojtjen e moralit dhe ruajtjen e interesit të gjinisë femërore nga amorali është ligji i poligamisë e cila do ta mbronte atë nga devijimi i nderit të saj. Një problematik e këtyllë e kemi edhe ne sot ku shohim se shumë ka të veja që kanë mbetur pa u martuar dhe enden rrugëve poshtë e lartë duke u marrë me amoralitet, Kjo është edhe njëra prej arsyeve që në botën moderne e legalizuan amoralitetin duke hapur shtëpi publike për ta nënçmuar nderin e femrës. Sheriati

⁵⁶Sure El-Bekare ajeti 235 fq. 77 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

Islam për këtë ka para parë ligjin e poligamisë me çka gjinia femërore do të gjejë kënaqësinë shpirtërore dhe do të ndien përgjegjësi bashkëshortore.

2.4.2. Shkaqet që ndërlidhen me dy bashkëshortëve

Shtimi i pasardhësve -Njëra ndër arsytet për paraqitjen e poligamisë është edhe rritja e nataliteti apo shtimi i njerëzimit për qëllim të ngritjes së numrit të punëtorëve, ushtarëve dhe gjithë andej ku paraqitet nevoja për të, po ashtu te myslimanët është hadithi i profetit paqja qoftë mbi të ku thotë : “Martohuni, lindni shumë fëmijë dhe shtohuni, sepse unë do të krenohem me ju para popujve Ditën e Gjykimit.”⁵⁷

Nëse marrim parasysh lindjet të cilat bëhet në rruzullin tokësor do të shohim që prej vitit në vit kemi rrënje të saj, në disa shtete kanë vendosur si ligje edhe shtesa fëmijërore për ata që do kenë nga tre ose katër fëmijë, ngase anketat e fundit tregojnë që shumica e femrave kanë nga një lindje ose planifikojnë të kenë vetëm një lindje e cila në të ardhmen do të prodhon probleme të ndryshme.

Dhënia pas epsheve. – Thotë All-llahu xh.sh. në Kuran: “All-llahu dëshiron t'ju lehtësoj (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paaftë (për t'u përballuar epsheve).”⁵⁸ Kemi raste kur është menduar se meshkuj janë të dhënë pas epsheve, e që posedojnë fuqi fizike, si dukuri e hasim më së shpeshte te ata femra te të cilat ju zgjatin një kohë të gjatë menstruacionet disa burra nuk kanë mundësi të bëjnë durim gjatë kësaj periudhe dhe poligamia është një shërim për ta dhe mbrojtje nga disa probleme që mund të ndodhin brenda shtëpisë, ose femrat të cilat janë të shtyra në moshë. Në shumicën e rasteve mashkulli ka epush më shumë sesa femra dhe është i gatshëm për marrëdhënie gjatë gjithë jetës së tij, kurse gruaja është e gatshme për këtë deri kur mbush të 50 - 55vjeçare. Pas kësaj moshe gjaku i menstruacioneve ndërpritet dhe fillojnë të zhduken vezët e shumimit. Dhe nëse gruaja nuk mund të kryejë obligimet bashkëshortore ndaj burrit, si p.sh. të lindë fëmijë apo të bëjë marrëdhënie me të, kur dihet se në këtë kohë pas zhdukjes së vezëve të shumimit gruaja humb epushin e saj, a nuk është më

⁵⁷Munavi, Fejdu'l-Kadir, vëllimi III fq. 269.

⁵⁸Sure Nisa ajeti 28 fq. 133 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

mirë për burrin të martohet edhe me një grua dhe kështu të ruhet nga haramet sesa të zërë ndonjë dashnore në haram, ose ta divorcojë atë për shkaqe bio – fizike.

Steriliteti i gruas. – Ka mundësi në disa raste që gruaja të jetë sterile dhe nuk lind ose ka ndonjë sëmundje prej së cilës nuk pritët shërimi dhe dëshiron të vazhdojë jetën me burrin e saj dhe në të njëjtën kohë burri dëshiron të ketë fëmijë dhe të ketë një grua e cila mbikëqyr kërkesat e shtëpisë. Në këtë rast, a është më e mirë që burri të jetë i kënaqur me këtë gjendje të dhimbshme duke shoqëruar gruan e tij pa pasur fëmijë dhe kjo grua e sëmurë pa pasur dikë që kujdeset për shtëpinë e të përballojë të gjitha këto humbje, apo është më mirë ta shkurorëzohet këtë grua duke pasur dëshirë ajo që të vazhdojë jetën me këtë burrë dhe ai do ta lëndojë atë me shkurorëzim, ose të bashkojë dëshirën e saj dhe dëshirën e tij e të martohet edhe me një grua e ta mbajë edhe të parën në shtëpi dhe kështu do të ketë dobi edhe ai edhe ajo. Një situatë të këtillë e patë edhe Ibrahim profet i Zotit ku Sara bashkëshortja e tij kur pa dëshirën për të pas fëmijë apo pasardhës i afroj atij martesën me shërbëtoren e saj Haxheren me të cilën edhe Zoti i dha të ketë djalë Ismailin i cili poashtu u bë profetë. Prandaj edhe Islami ka vendos që në vend të shkurorëzimit si shkak i sterilitetit derisa kanë dashuri çifti në mes tyre më mirë është prapë të martohet me të dytën të cilën do ta duaj dhe do të ketë pasardhës se sa ta shkurorëzohet të parën. Islami preferon më shumë në këtë rast poligaminë se sa shkurorëzimin.

Mosmarrëveshja në mes dy bashkëshortëve - Jeta martesore është e tillë që pamvarësishtë bukurisë dhe fryteve që prodhon ajo familje, ndodh që në një jetë apo bashkësi martesore të ketë mosmarrëveshje të cilët shpesh herë me përmasa serioze, rrugëdalja e së cilës e kanë gjetur në zgjidhjen e martesës apo me shkurorëzim. Por nga ana tjetër nga praktika në raste të tilla për të ndaluar mosmarrëveshjet mundësia e martesës së dytë të burrit ka ndikuar që shumë gra ti tejkalojnë këto probleme dhe ti përmisojnë marrëdhëniet familjare.

2.5. Kushtet e poligamisë në jurisprudencën islame

Poligamia si lloj i martesës së lejuar por jo edhe i obliguar ka kushtet e veta që në mungesë të tyre edhe kjo martesë nuk do të kishte efikasitetin e saj. Kushtet që duhet të plotësohen në një martesë poligamie janë si në vijim : Numri i grave në një martesë, drejtësia ndaj bashkëshorteve, mundësia e furnizimit, ndalimi i bashkimit të afërmeve në një kurorë

Numri i grave në një martesë - Edhe përkundër asaj që gjatë historisë së njerëzimit ka pasur lëvizje të ndryshme për martesë poligame, ka hasur për çdoherë në ndryshme, ka pasur prej atyre që kanë pasur vetëm një bashkëshorte, por ka edhe prej atyre që kanë pasur me qindra gra në një martesë, atë që cekëm edhe më lartë që vetëm se në kohën e injorancës kemi pasur martesë të arabët me dhjetëra gra, por edhe traditat e tjera të popujve të ndryshëm kemi hasur që kanë pasur disa gra me një martesë ose një grua dhe disa dashnore për të cilën bashkëshortja ka qenë e njoftuar, por si do qoftë e gjithë kjo ka qenë pjesë e historisë, kurse me ardhjen e Islamit ajo nuk e lejoi që martesat me më shumë se një grua të jetë e lejuar sipas dëshirës njerëzore apo sipas tekëve të dikujt që kohë pas kohe mund të ndryshojë, por Islami vendosi kufizim ku ua përcaktoi numrin e grave të cilat mund ti kenë me një martesë ku në versetin Kuranor thuhet : Në qoftë se frikoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri e me katra.....⁵⁹, me këtë ajet u rrumbullakosua numri i bashkëshortëve në katër dhe jashtë kësaj nuk kanë të drejtë mbi martesat e tyre. Kur zbriti ajeti Kuranor që cekëm më lartë në mesin e shokëve të profetit kishte prej atyre që ishin të martuar me pesë apo dhjetë gra me një kurorë dhe po të njëjtët ju drejtuan profetit për këtë çështje ndërsa ai ju përgjigje duke ju thënë : “Zgjidhi katër prej tyre.”⁶⁰

Martesa me gruan e pestë në jurisprudencën Islame konsiderohet Haram – e ndaluar rreptësisht derisa bashkëshortët e më para që të 4 janë gjallë dhe në kurorë. Me vendosjen e këtij rregulli në jurisprudencën Islame u kufizua martesat e poligamisë deri në 4 gra.

⁵⁹Surja en – Nisa ajeti 3 fq. 127 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

⁶⁰Tirmidhi vëll. III fq. 436 nr.1129

Drejtësia ndaj bashkëshorteve - Islami e kushtëzon myslimanin që në martesën e tij me më shumë se një grua të jetë i drejtë në mes tyre duke mos anuar nga njëra ma shumë se te të tjerat, prandaj edhe ajeti Kuranor thotë : “...E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një...”⁶¹, poashtu transmeton Ebu Hurejra se profeti paqja e Zotit qoftë mbi të ka thënë: “Kush i ka dy gra dhe nuk sillet në mënyrë të barabartë ndaj të dyjave, do të vijë në Ditën e Gjykimit me një anë e cila do të jetë e lakuar!”⁶²

Drejtësia e kërkuar këtu ka të bëjë në disa pika si që është:

- Drejtësia ndaj bashkëshorteve, bazohet mbi lidhjen e kontratës, respektivisht, se ajo është në lidhje martesore, e jo në bazë të ndonjë cilësi, tipar apo virtyt të saj, si për shembull, për shkak të bukurisë, viteve, prejardhjes së saj etj.
- Barazia mes bashkëshorteve në sjelljet dhe kujdesin ndaj tyre në mënyrë të barabartë dhe të njëjtë.
- Banimi dhe vendqëndrimi të jetë i barabartë mes të gjitha bashkëshorteve.
- Barazi në bujtje dhe në shtrat (në marrëdhëniet intime).
- Barazia në ceremoninë e martesës.
- Barazia në veshmbathje duke mos i dalluar njërin nga tjetra.
- Mos dallimi i asaj që e ka martuar të virgjër dhe atë që e ka martuar të vejë.
- Mos dallim të asaj që e ka më të re në moshe dhe atë që është shtyrë në moshë.

⁶¹Surja en – Nisa ajeti 3 fq. 127 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

⁶²Termidhiu vëll. III fq. 447 nr. 1141

Bashkëshorti është i obliguar për këtë drejtësi edhe kur është i shëndoshtë por edhe kur është i sëmurë, qoftë kjo edhe në shtratin e vdekjes, Muhammedi a.s. në shtratin e vdekjes : “ kërkoi leje nga nga gratë e tjera që të dergjete në dhomën e Aishes (bashkëshortja e Muhammedit a.s.)”, ndërsa të gjitha njëzëri iu përgjigjen kërkesës së Pejgamberit alejhi selam.⁶³

Në udhëtim bashkëshorti mund të zgjedh njërën prej tyre që ta marrë me vete nëse ai e parasheh se ajo është në gjendje ti përballoj vështirësive të udhëtimit dhe zgjedhja e tij nuk do ndikonte negativisht te grat e tjera, në të kundërtën ka këtë të drejtë ua lejon grave që ata ta zgjedhin mënyrën e marrëveshjes për t’iu bashkangjitur udhëtimit.

Drejtësia e cila kërkohet këtu ka të bëjë më së shumti me çështjet e jashtme për të cilat njeriu është në gjendje ti sistematizoj dhe ti vendos në veprim pa asnjë pengesë, kurse sa i përket dashurisë ajo është ndjenjë e cila është pjesë e zemrës ku vendin e tyre nuk mundesh që ti ta ndash me metër apo kilometër, por duke patur kujdes që mos të anosh nga njëra ma shumë se te tjetra, dhe këtë e vërteton hadithi i profetit ku thotë : “O Zot, kjo është mundësia ime, o Zot kjo është ndjenja ime në atë që posedoj, atëherë mos më qorto në atë që e posedon Ti e unë nuk e posedoj.”⁶⁴

Lidhur me këtë Zoti thotë: “ Ju kurrsesi nuk do të mund të mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni, pra mos anoni plotësisht nga ndonjëra e të lini tjetrën si të varur.”⁶⁵

Dijetarët Islam rrethë këtij ajeti thonë se njeriu nga vetë instinkti i tij nuk mund të jetë i barabartë me të gjitha njëjtë në dashuri prandaj edhe më pas Zoti urdhëron që ne si krijesa mos të anojmë plotësisht ndaj njëres e të tjerat ti lemë anash. Sipas të drejtës Islame nëse bashkëshortja e parë sheh bashkëshorti anon nga njëra ka të drejtë që të kërkoj shkurorëzim te gjykatësi duke e vërtetuar nënçmimin dhe padrejtësinë që i është bërë asaj, kurse nëse bashkëshortja e parë e ka kushtëzuar në kontratën e martesës që mos të ketë të dytën dhe burri ka martuar të dytën atëherë nuk ka nevojë që të paraqet kërkesën te gjykatësi ngase vetë kushtëzimi dhe mos respektimi i saj e prishë kontratën e martesës.

⁶³Ibn Maxhe vëll. I fq. 517 nr. 1618

⁶⁴Termidhiu vëll. III fq. 446 nr. 1140

⁶⁵Surja en – Nisa ajeti 129, fq. 150 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

Mundësia e furnizimit - Prej Abdullah bin Mes'udit r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: O ju të rinj, kush ka prej jush mundësi dhe kushte (për martesë) le të martohet, sepse martesa i ruan sytë nga të shikuarit në gjëra të ndaluara dhe e ruan nderin. E kush nuk ka mundësi (të martohet), le të agjërojë sepse agjërimi për të do të jetë mbrojtje.⁶⁶

Duke u nisur nga kjo thënie e profetit e shohim se martesa për të qenë e pranuar- valide e në veçanti poligamia duhet të kesh mundësi materiale për ti mirëmbajtur bashkëshortet me të cilat je martuar ose ke vendosur për tu martuar. Mundësia materiale nuk ka të bëjë vetëm furnizimi me ushqim për një kohë të caktuar dhe gjërat tjera të jenë më pak të rëndësishme, por me aspektin material në kohën moderne do të ishte që çdonjëra prej grave të ketë shtëpi të vetën në të cilën do të ishte zonja e asaj shtëpie, pastaj nëse ndonjëres do i blejsh një dhurata atëherë duhesh që të gjithave tu blejsh dhurata me çmim dhe vlerë të njëjtë dhe nëse ankohesh nga pamundësia për ti përmbajtur materialisht bashkëshortet atëherë për atë burrë nuk është e preferuar poligamia.

Mos ekzistimi i pengesave - Ajo që është detyrim sipas islamit, është fakti se kontrata e martesës mes dy palëve, për të qenë e shëndoshë – e vlefshme është kusht që të mos ekzistojë ndonjë pengesë juridike që pengon lidhjen e kontratës së martesës.

Argument për martesa të ndaluara kemi ajetin kur'anor ku All-llahu xh.sh. thotë: "U janë ndaluar juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gji, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjehrrat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt, e nëse nuk keni pasur kontakt me to (me gratë), atëherë s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza), dhe (janë të ndaluara) gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijve të adoptuar), dhe të bashkoni (përnjëherë në një niqah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtetë, All-llahu falë shumë, është mëshirues i madh. "⁶⁷

⁶⁶Sahihi Buhari përk. Feti Mehdiu, vëll. X fq. 409 nr, 5065 Prishtinë 2014

⁶⁷Surja en – Nisa ajeti 23, fq. 131 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

Poashtu edhe ajeti tjetër “ (Nuk u lejohet të martoheni) Edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robërshat e luftës). (Ky është) obligim mbi ju nga All-llahu. U janë lejuar, pos këtyre (që u përmendën), të tjerat që t'i merrni me pasurinë tuaj (me niqah) duke pasur për qëllim bashkëshortësi e jo prostitucion. E për atë që përjetuat ju nga ato (gratë me të cilat patët kurorë), jepuni shpërblimin e tyre të caktuar se është obligim. E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (të niqahut), në atë që ju pëlqeni mes vete. All-llahu është i gjithëdijshmi, i urti.”⁶⁸

Juristët islamë, kur diskutuan rreth këtyre ajeteve në detaje, konstatuan se pengesat e kurorëzimit sipas jurisprudencës islame janë dy lloje, që janë:

- Pengesa të përhershme, që nënkupton se me ekzistimin e këtyre pengesave, apo njëres prej tyre, kontrata e martesës është e ndaluar përgjithmonë mes këtyre dy palëve.

Ndalesat e martesës së përhershme përqendrohen në njërin prej këtyre tre shkaqeve që janë:

Nga afërsia e gjakut: Nëna, Nëna e Nënës, Nëna e Babës, Vajza, Vajza e Djalit, Vajza e Vajzës, Motra, Motra prej Nënës, Motra prej Babës, Vajza e Vëllait, Vajza e Vëllait prej Babës, Vajza e Vëllait prej Nënës, Vajza e Motrës, Vajza e Motrës prej Nënës, Vajza e Motrës prej Babës, Halla, Halla e Nënës, Halla e Babës, Tezja, Tezja e Nënës, Tezja e Babës.

Nga miqësia: Gruaja e Babës, Gruaja e Djalit, Nëna e Gruas (Ndalesa e tyre vjen në konsiderim posa të bëhet Kurora me të), Vajza e Gruas (pasi të ketë pasur diçka me nënën e saj).

Nga qumështi: Nëna nga Qumështi, Nëna e Nënës, Nëna e Babës, Motra nga Qumështi, Vajza e Vëllait nga Qumështi, Vajza e Motrës nga Qumështi, Halla nga Qumështi, Tezja nga Qumështi, Vajza nga Qumështi (që ka pi Qumësht nga Gruaja juaj)

- NDALESAT E PËRKOHSHME

Bashkimi i dy Motrave në një Kurorë, Bashkimi i Gruas me Hallën e saj, i Gruas me Tezen e saj (në një Kurorë), Martesa me Paganen (Idhujtaren), Gruaja e martuar, Gruaja, derisa është në

⁶⁸Surja en – Nisa ajeti 24, fq. 132 përkthim nga Ahmed Sherifi, Prishtinë 1988

Idet, Gruaja e lëshuar mbi 3- herë –radhas, Martesa me më shumë se katër Gra (në një Kurorë) – edhe më lartë kurrë folëm për numrin e caktuar në poligami të grave cekëm se ai ishte maksimum 4 dhe jashtë asaj nuk mundet, pra për një burrë është e ndaluar martesa me të 5 e në vazhdim,

2.6. Të metat dhe dobitë e Poligamisë

Të Metat e poligamisë

Në kohën e civilizimit dhe modernizmit tash kur bota jehon nga literaturat e ndryshme, kur njeriu mendon që ka arritur kulmin e njohurive doemos shohim se ka ndarje rreth çështjeve të caktuara e njëjta gjë ndodh edhe në çështjen e poligamisë e cila i referohet për çdoherë vetëm Islamit edhe këtu kemi ndarje të mendimeve të cilët një pjesë e tyre e pranojnë martesën e tillë dhe e përkrahin atë por nga ana tjetër kemi edhe grupin tjetër që nuk e pranojnë këtë martesë apo edhe që e kundërshtojnë atë, ngase një gjë e tillë është shkelje ndaj lirisë dhe nderit të gruas, kurse dashnoret dhe fëmijët jashtëmartesor janë në rregull derisa janë në fshehtësi nga bashkëshortja që e ka në kurorë. Që të dy palët edhe ata që e përkrahin edhe ata që e kundërshtojnë poligaminë janë të një mendimit sa i përket problematikave të cilat bashkëshorti dhe bashkëshortet i hasin në një martesë të tillë.

Problematikat që i kanë hasur dhe që i hasin në martesa të këtilla janë :

1. Xhelozia e bashkëshortes- gruas.
2. Pamaturia dhe shfrenimi i bashkëshortit.
3. Mosmarrëveshjet dhe grindjet mes fëmijëve të dy bashkëshorteve.
4. Probleme ekonomike- financiare- mirëmbajtja e familjes.
5. Problemi i banimit dhe shtëpive ku do të banojnë ato.
6. Problemi i planifikimit të familjes. (mos dëshira për lindje të fëmijëve, respektivisht, pakësimi ose shtimi i natalitetit).

Ne do të ndalemi vetëm në pika të shkurta në sqarimin e këtyre problematikave si pasojë e poligamisë.

Xhelozia e bashkëshortes gruas - Xhelozia është njëra nga emocionet më shkatërruese ose ndjenjë e cila një njeri ka drejt qenies njerëzore tjetër. Ajo, shkakton te njeriu një dëshirë të ligë për të tjetër dhe të jetë i gëzuar kur fatkeqësitë bien mbi ta, dhe në rastet e martesës së poligamisë hasim me këtë lloje problematike që njëra prej grave ose të gjitha të xhelozojnë njëra tjetrën dhe atë nga arsye të ndryshme si që është: bukuria, mosha, fëmija, etj.

Ibrahimi profeti i Zotit edhe pse ishte i martuar me dy gra ku Haxheren gruaja e dytë e tij i a patë sugjeruar gruaja e para Sara dhe te kjo e fundi pas një kohe lindi xhelozia kur shiftë se si Ibrahimi po luante me djalin e tij nga gruaja e dytë dhe arriti deri në atë shkallë sa që kërkoi nga bashkëshorti i saj që ta largoj nga shtëpia me një vend ma të largët.

Për xhelozinë e gruas kemi shembujt edhe nga praktika e familjes së profetit Muhamed a.s. Bashkëshortja e tij Ajshja-nëna e besimtarëve r.a. thotë: “Për asnjë grua të të Dërguarit a.s. nuk kam xhelozuar sa për Hatixhen, për shkak se i Dërguari a.s. e përmendte shpesh dhe e lavdëronte. Atij i është shpallur nga Allahu që ta përgëzonte atë me një pallat në Xhenet”.⁶⁹

Po ashtu njihet mirë edhe rasti i njëjës nga gratë e Pejgamberit a.s., e cila ishte në shtëpinë e Muhamedit a.s. kur shërbëtori ia solli ushqimin e ajo i ra me dorë pjatës, ushqimi u derdh dhe kështu theu pjatën, e Muhamedi a.s. filloi të mbledhte copëzat e pjatës së thyer së bashku me ushqimin, dhe thoshte: “Xhelozoi nëna juaj”.⁷⁰

Me këtë tregohet se xhelozia ndaj grave të tjera e konsideron si e drejta e saj dhe për t’i fituar të drejtat e saj bëhet pjesë e hakmarrjes nga kushdo qoftë etj.

Nga ky shembull mësojmë se si dëshiron t’i hakmerret femra asaj që konsideron se e ka dëmtuar-në këtë rast për shkak të martesës poligamie, pa marrë parasysh pozitën e palës tjetër. Edhe kjo dukuri ka patjetër ndikime tek femra, sikur janë: shfaqja e frymës së hakmarrjes dhe kjo rezulton si virtyt që ka ndikim negativ

⁶⁹Sahihi Buhari vëll. X faqe 495 nr.5229- përk. Feti Mehdiu, Prishtinë 2014

⁷⁰Sahihi Buhari vëll. X faqe 495 nr.5229- përk. Feti Mehdiu, Prishtinë 2014

Nga ndikimet negative të xhelozisë mund të numërojmë: pyetjet e shumta nga ana e saj, qoftë edhe për gjëra të imëta; shqetësimi dhe ankthi që godasin gruan në administrimit të mbretërisë së vogël të saj-familjes; shtimi i dyshimeve dhe i cytjeve si rezultat i dobësimit të fuqisë dhe energjisë. Këto defekte ndikojnë patjetër në jetën e përditshme, si në shijimin e gëzimit ashtu dhe në përballimin e vështirësive.

Pamaturia dhe shfrenimi i bashkëshortit - Pamaturia dhe shfrenimi i bashkëshortit, ndodh që një burrë që ka më shumë se një grua duhet të dijë të jetë i matur ndaj tyre dhe jo të anoj nga njëra për shkak moshën së re që ka ose bukurisë dhe ndaj atyre që i ka martuar ma herët të sjellët me pamaturi ose te ato të shpreh gjitha fjalët e këqija duke e bërë që të ndihen ato të ofenduara, këtu njeriu duhet që të jetë shumë i kujdesshëm që të jetë i matur në veprimet e tij , sjelljet e tij, por edhe pas gjithë asaj kujdesie prapë do të ballafaqohet me këtë situatë me dashje apo pa dashjen e tij.

Mosmarrëveshjet dhe grindjet mes fëmijëve të dy bashkëshorteve - Mosmarrëveshjet dhe grindjet mes fëmijëve të dy bashkëshorteve te shqiptarët në përgjithësi për çdoherë dëgjojmë se si kunata ankohen njëra prej tjetrës për shkak fëmijëve, grindjet, kacafytjet të cilat i bëjnë fëmijët në mes tyre dhe kemi dëgjuar dhe ndarje në mes vëllezërve shkak i fëmijëve, edhe këtu kemi të bëjmë me një situatë të ngjashëm ku grat të cilat kanë pranuar një martës poligamie dhe kanë jetuar e bashkëpunuar bashkë me rritjen e fëmijëve dhe lojërave të tyre ku pjesë e saj është e zënkat arrin që te bashkëshortet apo nënat e tyre të krijojnë një lloje inati ndaj fëmijës nga nëna tjetër dhe kjo skadon shpesh në problematik të cilën nëse bashkëshorti nuk do të dijë ta menaxhojë mund të kaloj edhe në vrasjen e fëmijës nga nëna tjetër.

Probleme ekonomike- financiare- mirëmbajtja e familjes - Probleme ekonomike-financiare- mirëmbajtja e familjes, bashkëshorti ashtu si thamë edhe më herët ai është trangu i familjes i cili do ta mbaje në barazi dhe drejtësi këtë familje të tij me më shumë se një grua, dhe është plot normale që gjatë jetës të ketë batica dhe zbatice në financat e tija por të njëjtën

kohë ai duhet të dijë ta menaxhojë këtë situatë që më së paku ti largohet problemeve të mëdha të cilat mund të lindin nga kjo situatë,. Bashkëshorti duhet po ashtu të jetë i kujdesshëm në financimin e tyre që për çdonjërin të ketë harxhime të njëjta etj.

Problemi i banimit dhe shtëpive ku do të banojnë ato - Problemi i banimit dhe shtëpive ku do të banojnë ato një pjesë e dijetarëve janë të mendimit që një burri që bënë martës poligamie ai duhet që atyre tu sigurojë nga një shtëpi në afërsi të njëra tjetrës dhe të bëhet veshje dhe zbukurimi i tyre sipas vendosjes së burrit, ngase nëse ua le në dorë grave edhe përskaaj zgjedhjes së saj prapë do ketë ankesë se ajo tjetra ka blerë më shtrenjte ose për të është harxhuar më tepër se për këtë

Problemi i planifikimit të familjes - Planifikimi familjar është një nga të drejtat themelore të njeriut të gjithë individëve dhe çiftet për të vendosur lirisht për krijimin e një familje dhe lindjen e fëmijëve. Pra planifikimi i familjes është e drejta e individëve dhe çifteve që të informohen, të parashohin dhe vendosin lirshëm mbi numrin, shpeshtësinë dhe kohën në të cilën ata duan të kenë fëmijë. Planifikimi i familjes paraqet një fenomen kompleks i cili përfshin elemente të ndryshme të lidhura me vete të natyrës: biologjike, demografike, shëndetësore, sociologjike, psikologjike, ekonomike, etnike dhe politike. Problemi i planifikimit të familjes, mos dëshira për lindje të fëmijëve, respektivisht, pakësimi ose shtimi i natalitetit të gjitha këto janë probleme të poligamisë në të cilat njeriu hasë në jetën e tij, edhe pse më herët cekëm se poligamia është njëra prej shkaqeve për shtimin e nataliteti në të njëjtën kohë kemi edhe si problematik në mes bashkëshortëve ku njëra mundet që të mos dëshiroj të ketë fëmijë, ose të jetë sterile dhe ata e nxjerrë si problematik, ose mund që gruaja të planifikojë vetëm një fëmijë të ketë e cila është në kundërshtim me dëshirën e bashkëshortit ose të lindin fëmijë shumë dhe të ketë një numër të madhe të fëmijëve e cila është prapë si problem ngase ato fëmijë kërkojnë edukim dhe kujdes secili në vete, dëshirojnë ta ndejnë dashurin e prindërve etj. Bashkëshorti në veçanti gjatë kësaj martese duhet të ketë kujdes të veçantë në atë që kërkon dhe atë që duhet të bëjë, ngase mund të ballafaqohet me problematika të llojeve të ndryshme dhe mos përgatitje e tij për tejkalimin e këtyre situatave do e sjellë atë para një

zhgënjimit të madh dhe shkatërrimin e vetë familjes dhe jetës së tij nga shkak i mos pasjes njohuri të mjaftueshme për jetën të cilën ka zgjedhur të jetojë.

Poligamia edhe pse nga njëra anë është zgjedhje e shumë problematikave në jetën shoqërore ajo në të njëjtën kohë ka brenda saj problemet me të cilat do të evidentoheshin si këto më lartë, dhe për një popull ku poligamia do ishte vetëm mbushje e epsheve apo shfryrje e tyre padyshim do vinte deri te këto probleme të cilat s'do të dinte si ti kalonte e as ti frenonte këto probleme, edhe në kohën e sodit njerëzit të cilët janë të mendimit për një martesë poligamie shumica e tyre nuk i njohin as rregullat bazë të poligamisë dhe një gjë të tillë e paramendojnë vetëm në atë se të ketë 4 gra me të cilat do të ketë një jetë seksuale dhe gjitha gjërat tjera nuk janë të rëndësishme, kemi raste ku një njeri ka dy gra me të cilat fle me një dhomë të ndarë me një perde duke u arsyetuar se as i ka dhënë Krijuesi i gjithësisë prej pasurisë dhe se Profeti ka urdhëruar të jemi të barabartë ndërsa po i njëjti harron se Profeti ishte ai i cili grave ua ndau nga një dhomë e nuk i ndau me një perde në mes, Prandaj lloji i këtyre njerëzve sot edhe ka sjellë deri në keqkuptimin e asaj që lejon Islami gjatë një poligamisë dhe asaj që njerëzit e shfrytëzojnë gjatë një poligamisë. Një burrë duhet të ketë kujdes gjatë shfrytëzimit të drejtës së tij qoftë ajo e obligueshme apo e pëlqyer që paraprakisht të ketë njohuri rreth asaj që sjellë ajo martesë problematikat dhe dobitë e saj.

Dobitë e poligamisë

1. Ruajtja e gruas dhe ruajtja e dinjitetit të saj.
2. Rritja e natalitetit.
3. Mos pasja e nevojës për shtëpi publike.
4. Largimi i burrit nga zinaja.
5. Ulja e divorceve
6. Parandalimi i përhapjes së sëmundjeve
7. Forcon lidhjet shoqërore.

K A P I T U L L I I I I

3. POLIGAMIA SIPAS LEGJISLACIONEVE

3.1. Poligamia në legjislacionet e shteteve islame

Vetëm përmendja e asaj që kemi të bëjmë me shtetet Islame na jep të mendojmë se gjithçka që është Islame edhe praktikohet në këto shtete Islame, por nëse hymë dhe shohim ligjet e sjellë posaçërisht rreth poligamisë do të vërejmë se ka ndryshme nga ajo Islame edhe pse thirren në emër të Islamit. Gjatë kohës mendimet individuale janë formuar dhe kanë filluar të zhvillohen në drejtime të ndryshme. Është formuar bërthama e shkollave të së drejtës më vonë të themeluara, që e ka dëmtuar lidhshmërinë themelore të myslimanëve për Sheriatin. Heqja dorë nga lidhshmëria direkt për Sheriatin, siç do të shohim më vonë, nuk ka qenë qëllim i asnjë juristi klasik. Ata kanë dëshiruar t'i ndihmojnë çdo myslimani ta mbajë, në çdo rast të ri, lidhjen e gjallë me tekstin themelor të Sheriatit. Roli i tyre ka qenë ta komentojnë, ta aplikojnë dhe të japin mendime mbi aplikueshmërinë e tekstit të caktuar në rastin e caktuar, apo, në mungesë të tekstit të tillë, t'i shtrojnë qëndrimet vetjake. Për çdo mysliman, fuqia e qëndrimit të tillë varej, ose do të duhej të varej, siç kemi përmendur, nga ajo se sa pajtohet me tekstin kur'anor apo pejgamberik, përkatësisht sa i plotëson qëllimet e tyre. Kështu, varieteti i mendimeve juridike do të duhej konsideruar për simbol të fleksibilitetit të Sheriatit, e jo për karakteristikë të tij dogmatike. Ky fleksibilitet mund të kuptohet vetëm nëse hulumtimi i sheriatit i paraprinë udhëtimit të pafund nëpër punimet e juristëve. Madje as kjo nuk mjafton. Gjatë tërë këtij udhëtimi, nuk duhet ta heqim nga mendja faktin e thjeshtë se islami, në kuptim të ligjit obligator, është përcaktuar përgjithmonë me Kur'an dhe Sunnet.

Në kushtetutat e vendeve bashkëkohore myslimane mund të gjenden ndikimet e ideologjive të ndryshme juridike. Disa kushtetuta manifestojnë idetë e liberalizmit klasikë evropianë (republikat dhe monarkitë parlamentare), të dytët edhe më tej përdorin terminologjinë e marksizmit tashmë të harruar (demokracitë popullore), të tretët tentojnë t'i bashkojnë parimet islame dhe format evropiane (të republikës islame). Këto ndikime, së bashku

me ndryshimet e shpeshta të udhëheqjes politike, me rolin dominues të ushtrisë, me oscilimet në orientimet ideologjike e të ngjashme, flasin vetvetiu për gjurmimin e botës myslimane drejt identitetit vetjak dhe të manifestimit të tij me forma përkatëse. Kushtetutat e vendeve myslimane, në një mënyrë të caktuar e përmendin Islamin dhe simbolet e tij. Por në këto vende bashkëkohore myslimane mund të identifikohen tri modalitete të rregullimit të raporteve të sheriatit dhe legjislacionit nacional. Një numër më i vogël i vendeve e ka shpallur sheriatin burim të vetëm të të drejtës pozitive. Po aq numër i vogël i vendeve myslimane në mënyrë formale juridike ka shfuqizuar sheriatin si burim të të drejtës nacionale. Shumica e vendeve myslimane ka pranuar pozicionin e mesëm sipas të cilit sheriatit është njëri prej burimeve të të drejtës pozitive, zakonisht në fushën e statusit personal të myslimanit. Duke u nisur nga ky fakt që shtetet që njihen si myslimane në brendësinë e saj kanë ndryshime në vetë aplikimin e të drejtës Islame medoemos edhe çështjen e poligamisë apo martesës me disa gra e shohin në mënyra të ndryshme dhe të njëjtën e aplikojnë me nen të ndryshme. Nga kjo del që çështja e poligamisë është e ndarë në tre grupe të shteteve të cilat e aplikojnë apo e ndalojnë atë dhe atë si në vijim (burimi)

1). Shtete Islame të cilat e lejojnë poligaminë janë : Libia, Sudani, Jemeni, Saudia, Kuvajti, Jordania, Libani,

2). Shtete Islame që e lejojnë poligaminë në rrethana dhe kushte të ndryshme janë: Algjeria, Egjipt, Sirisë, Marokut, Irakut,

3). Shtete Islame që e ndalojnë poligaminë janë: Tunizia, Turqia,

Shtetet e të gjitha grupeve të lartpërmendura janë vetëm një pjesë e tyre ngase ka edhe shtet të tjera që bëjnë pjesë në njërin prej këtyre grupeve të cilën nuk e kemi përmendur, por këta janë sa për ilustrim.

3.1.1. Shtete Islame të cilat e lejojnë poligaminë

Libia - Në të drejtën familjare mbi martesën me më shumë se një grua gjatë sundimit të Muhammed el – Gadafit kishte vendosur kushte për mundësin e martesës poligame, si veçanërisht pëlqimin e gruas së parë ose marrjen e aprovimit gjyqësor. Burri gjithashtu duhej të dëshmonte para gjyqësorit se ai ishte materialisht në gjendje të sigurojë një familje të madhe.⁷¹ Por pas pranverës arabe ku ishte pjesë e saj edhe ndryshimet në Libi me largimin e Muhammed el – Gadafit më saktësisht vrasjen e tij dhe fillimin e qeverisjes së re Gjykata Supreme e Libisë vendosi të heqë kufizimet për poligaminë e vendosur nga ish-regjimi.

Sudani - Në Sudan nga nëntori i 1996 në rrjedhë është procedura e sjelljes së kushtetutës së re. Në ndërkohë praktikisht qeveriset me dekrete të kryetarit. Në mungesë të tekstit të porsa miratuar apo projektit të tij, këtu do të hedhin vështrimin mbi kushtetutën e 12 prillit 1973. Kjo kushtetutë e ka shpallur sheriatin dhe traditat për burim kryesor të legjislacionit. Çështjet personale të jomyslimanëve do të jenë nën kompetencën e të drejtave të tyre personale (neni 9). Neni 16 ka garantuar mbrojtjen e barabartë të Islamit, Kristianizmit dhe religjioneve të tjera qiellore.⁷²

Sikur edhe në vendet tjera, është formuar komision i veçantë me qëllim t'i harmonizojë ligjet në fuqi me sheriatin. Detyra ka mbetur e papërfunduar deri në verën 1983, kur Xhafer En-Numeiri e ka shpallur planin për islamizimin e sistemit juridik. Ka filluar veprimtaria intensive legjislative e cila ka rezultuar që gjatë vitit të aprovohej kodifikimet e reja të të drejtës civile, tregtare, penale, procedurës dhe organizimit të gjyqësisë gjatë 1983-1984, kur El-Numeiri është hequr nga pushteti me grusht shtet më 6 prill 1984, u paraqit kërkesa për shfuqizimin e këtyre ligjeve. Nga arsyet e brendshme politike kjo nuk është bërë por disa prej tyre, sikur Ligji për të

⁷¹<https://www.aljazeera.net/news/miscellaneous/2013/2/6/%D9%84%D9%8A%D8%A8%D9%8A%D8%A7-%D8%AA%D8%B1%D9%81%D8%B9-%D8%A7%D9%84%D9%82%D9%8A%D9%88%D8%AF-%D8%B9%D9%86-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D8%AF-%D8%A7%D9%84%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA> e marra me datë 01.12.2019.

⁷²Carolyn Flucher-Lobban, *Islamic Law and Society in the Sudan*, London: Frank Cass, 1987, fq. 271-272.

drejtën penale, janë ndryshuar (1991). Regjimet vijuese, ushtarak nga viti 1989, qeveria kalimtare nga viti 1993 dhe qeveria e përzgjedhur nga viti 1996, nuk e kanë ndryshuar më thelbësisht pozicionin e shariatit në legjislacionin nacional. Poligamia është çështje e rregulluar me ligj e cila lejon martesën me më shumë gra për të gjithë komunitetet që jetojnë brenda shtetit, por në bazë të statistikave të fundit një veprim i tillë ka qenë në rrënje posaçërisht në Sudan dhe për këtë "Shoqata e Dijetarëve Sudanezë", përmes presidentit të saj, Profesor Mohamed Othman Saleh, bëri thirrje për praktikimin e poligamisë për të zvogëluar "përshkallëzimin e bashkëshortëve dhe shkallës së divorcit midis grave në vend".

Kjo e fundit pohoi se (nevoja është urgjente në këtë epokë për poligaminë në martesë për shkak të rrethanave të kërkuara nga disa faktorë, nevoja dhe probleme sociale që janë shfaqur në sipërfaqen e shoqërisë, ndër të cilat është edhe rritja e shkallës së divorcit midis bashkëshortëve dhe rritja e madhe e numrit të femrave në krahasim me numrin e meshkujve në shoqëritë sudaneze Me ritme të larta, të cilat mund të çojnë në probleme të njohura sociale, përfshirë devijimet e sjelljes dhe të tjerët⁷³

Saudia - Arabia Saudite, Sipas portalit .Republika.co.id thuhet se Mbretëria e Arabisë Saudite nxori një rregullore të re për burrat që duan të martohen, rregullimi u bë më i rreptë, me qëllim që të shmanget poligamia që zakonisht bëhet nga burrat e Arabisë Saudite. Për burrat që duan të bëjnë poligaminë duhet të kenë informacionin se gruaja e tij ka një sëmundje të caktuar, kështu që ai duhet të rimartohet. "Ai duhet të bashkëngjisë një raport nga një spital qeveritar që dëshmon se gruaja e tij po vuan nga një sëmundje kronike ose jopjellore," – tha komandanti i policisë së Mekës Assaf Al-Qurshi, ndërkohë, siç raportohet nga BBC, nëse gruaja e tij është në gjendje të mirë, nevojiten prova që partneri i saj lejon martesën.⁷⁴ Por edhe më tej në Saudi vazhdon aplikimi i sistemit të martesës deri me 4 gra pa pasur kushte, ku në disa

⁷³<https://www.sudantribune.net/%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D9%91%D9%8F%D8%AF-%D8%A7%D9%84%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA> e marur me datë 05.12.2019.

⁷⁴<https://internasional.republika.co.id/berita/internasional/timur-tengah/14/08/08/n9ylfx-cegah-poligami-kerajaan-arab-saudi-perketat-aturan-pernikahane> marur me datë 05.12.2019

rrjete sociale të krijuara nga vajza dhe gra nga Saudia i këshillonin bashkëshortët e tyre për martesën me të dytën.

Kuvajti – Kushtetuta e Kuvajtit nga 11 nëntori 1962, ngjashëm me Egjiptin, në nenin 2 e shpall Islamin për religjion shtetëror kurse shariatin islam për burimin kryesor të legjislacionit. Shteti është i obliguar ta ruajë “trashëgiminë islame dhe arabe dhe t’i kontribuojë përparimit të qytetërimit njerëzor” (neni 12). Trashëgimia është e garantuar si e drejtë e rregulluar me shariat (neni 18). Praktikisht, zbatimi i shariatit është përqendruar në fushën e statusit personal të myslimanëve dhe ka njëfarë ndikimi dhe në disa degë të tjera private-juridike. Poligamisë është e lejuar në Kuvajt dhe ate e dëshmonë statistika e fundit për martesën në vend ku zbuloi se në vitin 2017 kishte 1251 martesë poligamie, shumica e të cilave ishin për burrat kuvajtianë, nga 764 raste nga një grua në 3 bashkëshorte, me nënshkrimin e tyre në kohën e martesës në vitin 2017. Statistikat e martesës dhe divorcit për vitin 2017 të lëshuar nga Administrata Qendrore e Statistikave treguan se 1156 burra u martuan me "të dyten" në vit, përfshirë 689 Kuvajtian dhe 467 jo Kuvajtian, ndërsa numri i burrave që martuan me gruan e tyre të tretë arriti në 80, përfshirë 62 Kuvajtian dhe 18 jo Kuvajtian. Statistikat treguan se 15 burra zbatuan thënien "Sheriat i lejon katër", kështu që ata u martuan me të katërtin, përfshirë 13 Kuvajtianë dhe dy jo-Kuvajtianë. Sa i përket kombësisë së grave, numri i grave kuvajtiane që ishin grua e të dytë ishte 465 gra, dhe gratë jo-Kuvajtiane 691 gra, ndërsa numri i grave të tyre si grua e tretë ishte 35 Kuvajtiane dhe 45 jo Kuvajtiane, ndërsa numri i grave Kuvajtiane që ishin grua e katërt ishte 9 gra, dhe 6 prej tyre ishin jo Kuvajtiane.⁷⁵

Libani - Libani nuk ka religjion shtetëror, por Kushtetuta e tij nga viti 1990 në nenin 9 i garanton qytetarëve lirinë e ndërgjegjes. Shteti i respekton të gjithë fetë dhe siguron zbatimin e lirë të të gjitha llojeve të ritualeve me kusht që kjo nuk është në kundërshtim me rendin publik.

⁷⁵[https://alqabas.com/article/584105-1251-%D8%AD%D8%A7%D9%84%D8%A9-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D9%91%D8%AF-%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA-%D9%81%D9%8A-%D8%A7%D9%84%D9%83%D9%88%D9%8A%D8%AA-%D8%AE%D9%84%D8%A7%D9%84-2017 e marur me datë 07.12.2019](https://alqabas.com/article/584105-1251-%D8%AD%D8%A7%D9%84%D8%A9-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D9%91%D8%AF-%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA-%D9%81%D9%8A-%D8%A7%D9%84%D9%83%D9%88%D9%8A%D8%AA-%D8%AE%D9%84%D8%A7%D9%84-2017%20e%20marur%20me%20dat%C3%AB%2007.12.2019)

Shteti, gjithashtu, garanton që statusi personal dhe interesat fetare të qytetarëve të cilitdo lloj konfesionit do të respektohen. Në këtë shtet shumëfetar, të goditur me luftën shumëvjeçare, është ruajtur rregulli i autonomisë juridike të më shumë se pesëmbëdhjetë bashkësi fetare në gjerat e statusit personal. Në këtë kontekst, sheriati paraqet burimin e legjislacionit në gjerat familjare, trashëgimore dhe vakufore të myslimanëve. Sunitët pasojnë fikhun hanefi, shiitët shpjegimin juridik xhaferit, derisa të tjerët kanë kodifikim të tyre të veçantë.⁷⁶

Libani nuk ka martesë civile. Të gjitha martesat duhet të regjistrohen në Byronë Statistikore Vitale, "Të gjitha martesat në Liban kryhen nga një autoritet fetar dhe janë të regjistruara në juridiksionin e bashkëshortit të lindjes. Ata që dëshirojnë të kenë një martesë civile duhet të martohen jashtë vendit. Në raste të marrëdhënieve ndër fetare, secili partner mund të konvertohet në besimin e tjetrit për qëllimin e martesës".⁷⁷

"Megjithëse nuk ekziston një sistem për martesë civile në Liban, një martesë civile e një çifti të martuar jashtë Libanit njihet nga autoritetet libaneze me kusht që martesë të regjistrohet zyrtarisht në Ambasadën apo konsullatën libaneze në vendin ku është marrë vend."

⁷⁸

Pra Libani është lloj i atij shteti ku pa një kod civil të përbashkët për gjithë komunitetet që jetojnë aty, ato çështjen e saj e kanë lënë në dorën e autoriteteve fetare e cila ndër të tjerave ua lejon edhe martesën me më shumë se një grua për myslimanët.

3.1.2. Shtete Islame që e lejojnë poligaminë në rrethana dhe kushte të caktuara

Algjeria - Kushtetuta e Republikës Popullore të Algjerisë në referendumin e 23 shkurt 1989, në preambulën e vet disa herë referohet në Islam. Kështu theksohet që Islami është njëri prej komponentëve bazike të identitetit algjerian dhe se Algjeria është "vendi i Islamit". Neni 2 i kësaj kushtetute parasheh që: "Islami është religjion shtetëror." Liria e besimit dhe e mendimit është e pacenueshme (neni 36). Domeni i zbatimit të së drejtës shariatike është fusha private-juridike: statusi personal i myslimanëve dhe disa aspekte të së drejtës civile. Kjo ka gjetur

⁷⁶Antions Elias El-Gemayet, *The Libanese Legal System*, Georgetown (UK) International Law Institute, 1994.

⁷⁷<https://sq.insterne.com/si-te-martohesh-ne-liban/> e marur me datë 08.12.2019.

⁷⁸<https://sq.insterne.com/si-te-martohesh-ne-liban/> e marur me datë 08.12.2019

shprehje në Kodin Civil nga 28 shtator 1975 dhe në Kodin Familjar nga qershori 1984. Të drejtën e sheriatit e zbatojnë gjykatat nacionale të juridiksionit të përgjithshëm.

Ligji Nr. 84-11, i 9 Ramazanit 1404, që korrespondon me 9 Qershor 1984,
Ligji për familjen, i ndryshuar dhe plotësuar.

Neni 4:

Martesa (e modifikuar) Martesa është një kontratë vullnetare që zhvillohet midis një burri dhe një gruaje në formë ligjore, qëllimet e të cilës janë : formimi i familjes e që për bazë ka dashurinë, mëshirën, bashkëpunimin e ndërsjellët, mbrojtjen e bashkëshortëve dhe ruajtjen e gjenezës.⁷⁹

Neni 8:

Lejohet martesa me më shumë se një grua brenda kufijve të sheriatit Islame, kur ekziston arsyetim ligjor.

Bashkëshorti obligohet ta informoj bashkëshorten e parë dhe gruaja e parë duhet ta pranoj atë dhe ai duhet të parashtroj kërkesë deri te kryetari i gjyqit për lejimin e kësaj martese.

Kryetari i gjyqit mund të jep leje për martesën e re nëse konfirmon pëlqimin e dy palëve kurse bashkëshorti duhet ta vërtetoj arsyetimin ligjor dhe të ketë mundësi për realizimin e drejtësisë dhe plotësimin e kushteve të domosdoshme bashkëshortore.⁸⁰

Egjipt - Kushtetuta e Republikës Arabe të Egjiptit, e shpallur më 11 shtator 1971, kurse e plotësuar më 20 prill 1980, përmban në nenin 2 dispozitën që Islami është fe shtetërore, gjuha arabe gjuha zyrtare kurse parimet e të drejtës së sheriatit burimi kryesor i legjislacionit. Kjo dispozitë është futur në kushtetutë pas humbjes egjiptiane në luftën gjashtë ditësh me Izraelin

⁷⁹<https://www.joradp.dz/trv/afam>. e marur me datë 12.12.2019

⁸⁰<https://www.joradp.dz/trv/afam>. e marur me datë 12.12.2019

në vitin 1967, pas së cilës pasoi verifikimi i orientimit ideor të kombit dhe rritja e zhvillimit të revivalizmit islam. Grupet islame në vend e kanë shpjeguar dispozitën kushtetuese nga neni 2 si bazë për ndryshimin e legjislacionit të tërësishëm dhe harmonizimin e tij me shariatit. Qeveria ka marrë qëndrim se shariatit është burim efektiv vetëm në fushën e statusit personal dhe pjesërisht në të drejtën civile, pasi është i kyçur si një prej burimeve plotësuese të Kodit Civil nga 1948.

Shumë përpjekje të kodifikimit edhe të degëve të tjera të të drejtës në bazë të shariatit gjatë viteve të 1980-ta ka mbetur pa rezultate praktike.⁸¹

E drejta e shariatit në fushën e statusit personal të myslimanëve e zbatojnë nga 1955 gjykatat nacionale të kompetencave të përgjithshme, e jo gjykatat e veçanta shariatike. Jomyslimanët, nëse i përkasin grupit të njëjtë religjioz, janë nën juridiksionin e gjykatave të tyre konfesionale, të cilët në suaza të rendit publik, gjykojnë sipas të drejtës së vet kanonike.⁸²

Po. Edhe pse më pak se 3% e meshkujve egjiptianë kanë gra të shumta, një ligj i miratuar në 1985 lejon që një burrë të ketë katër gra. Në vitin 2000, u miratua një ligj i ri që lejon një burrë dhe një grua të bien dakord nëpërmjet një kontrate të nënshkruar që burri nuk mund të ketë më shumë se një grua.⁸³

Sirisë - Kushtetuta aktuale e Sirisë, e miratuar më 13 mars 1973, e përkufizon këtë vend si “shtet demokratik, popullor, socialist dhe sovran” (neni 1). Bazën ideologjike të kushtetutës e përbën mësimi socialist nëç interpretim të Partisë së Rilindjes Socialiste Arabe (Baath) dhe në këtë kontekst duhet shikuar pozicionin e Islamit dhe shariatit. Kushtetuta bazohet, si është theksuar në preambulën e saj, në katër parime kryesore: domosdoshmërinë e revolucionit të tërësishëm arab, unitetin arab, ndërtimin e socializmit krahas anticionizimit dhe antiimperializmit, lirive dhe demokracisë popullore.

⁸¹Fauzi M Najjar, *The Application of Sharia Laws in Egypt*, Middle East Policy, vol. I (1992), fq. 62-73.

⁸²Kihan Balz, *Submitting Faith to Judicial Scrutiny through the Family Trial: the Abu Zayd Case*, *Die Welt des Islams*, vol, 37, no. 2 (July 1997), fq. 144.

⁸³<https://sq.insterne.com/informacion-mbi-licencen-e-marteses-ne-egjipt> e marur me datë 12.12.2019

Neni 3 proklamon (1) që feja e kryetarit të Republikës duhet të jetë Islami dhe (2) që e drejta juridike islame është burimi kryesor i legjislacionit. E drejta në trashëgimi është e garantuar në pajtim me ligjin (neni 17), pa përcaktim se çka është burim i këtij ligji. Liritë religjioze janë të garantuara dhe shteti i respekton të gjitha religjionet (neni 39). Këto dispozita janë zbatuar në praktikë në atë mënyrë që sheriatit e përbën thelbin e të drejtës të statusit personal, të kodifikuar qysh nga 1953, dhe një nga burimet e Kodit Civil nga viti 1949, të punuar në bazë të modelit egjiptian.

Neni 67:

Nuk ka të drejtë që bashkëshorti të qëndroj me një banim me bashkëshorten e parë pa pëlqimin e saj dhe kjo e drejtë i takon asaj.⁸⁴

Neni 68

Kur bën poligami, burri është i obliguar të zgjedh strehimin e tyre⁸⁵

Këta dy nen sjellin në pah që patjetër duhet të plotësohen disa kushte si që është nene 67 që ka të bëjë me drejtësinë por edhe nen 68 që ka të bëjë me gjendjen financiare.

Marokut – Kushtetuta e Mbretërisë së Marokut nga viti 1992 në preambulë e përkufizon Marokun si “shtetin e pavarur myslimanë”. Islami është religjion shtetëror kurse shteti të gjithë qytetarëve u garanton lirinë e fesë (neni 6). Mbreti, i cili bartë titullin tradicional Emir el-mu’minin (komandant i besim drejtëve), siguron, ndër të tjera, respektimin e Islamit dhe kushtetutës (neni 19). Praktikisht, sheriatit përbën thelbin e të drejtës familjare, të kodifikuar në vitin 1957, dhe disa degëve të tjera privato-juridike, sikurse është e drejta tokësore.

⁸⁴قانون الأحوال الشخصية في الجمهورية العربية السورية (1953/59)

⁸⁵قانون الأحوال الشخصية في الجمهورية العربية السورية (1953/59)

Çështja e poligamisë në Maroku është rregulluar nëpërmjet kodit familjar moudawana e cila në kapitullin e martesës parasheh:

Neni 4:

Martesa është një kontratë juridike me të cilën një burrë dhe një grua pajtohen reciprokisht për t'u bashkuar në jetë të përbashkët dhe të qëndrueshme bashkëshortore. Qëllimi i saj është besnikëria, virtyti dhe krijimi i një familje të qëndrueshme, nën mbikëqyrjen e të dy bashkëshortëve sipas parashikimeve të kësaj Moudawana.⁸⁶

Neni 40:

Poligamia është e ndaluar kur ekziston rreziku i pabarazisë midis grave. Është gjithashtu e ndaluar kur gruaja përcakton në kontratën e martesës që burri i saj nuk do ta marrë një grua tjetër.⁸⁷

Neni 41

Gjykata nuk do të autorizojë poligaminë:

Nëse nuk justifikohet një arsyetim i jashtëzakonshëm dhe objektiv.

Nëse burri nuk ka burime të mjaftueshme për të mbështetur të dy familjet dhe për të garantuar të gjitha të drejtat e mirëmbajtjes, akomodimin dhe barazinë në të gjitha aspektet e jetës.⁸⁸

Neni 42

⁸⁶BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title One: Of Engagement and Marriage - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁸⁷BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁸⁸BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

Në mungesë të një parashikimi nga gruaja në kontratën e martesës që përjashton poligaminë, burri që dëshiron të drejtohet në të duhet të kërkojë gjykatën për autorizim. Peticioni i autorizimit duhet të përfshijë motive të jashtëzakonshme dhe objektive që justifikojnë kërkesën, dhe bashkëngjisin një deklaratë për gjendjen financiare të aplikantit.⁸⁹

Neni 43

Gjykata thërret gruan, burri i së cilës dëshiron të marrë një grua tjetër. Kur ajo pranon personalisht thirrjen dhe nuk paraqitet në gjykatë, ose nuk pranon të pranojë thirrje, gjykata i dërgon asaj një njoftim zyrtar nga një server procesi duke e udhëzuar atë që nëse ajo nuk paraqitet në seancën e caktuar në njoftim, kërkesa e burrit do të vendoset në mungesë të saj. Peticioni vendoset edhe në mungesë të gruas kur është e pamundur për Publikun Prokuroria të konstatojë adresën e saj të përhershme ose vendbanimin ku thirrja mund të dorëzohet.

Kur gruaja nuk merr thirrjen për shkak të transmetimit në shtëpi të një adrese false nga burri ose falsifikimit të emrit të gruas, burri pëson, me kërkesë të gruas së paragjykuar, gjobat e parashikuara në nenin 361 të penalitetit Code.⁹⁰

Neni 44

Seanca dëgjimore zhvillohet në dhomën e këshillimit në prani të të dy palëve, dhe të dy dëgjojnë për të arritur marrëveshje dhe pajtimin e tyre pas një shqyrtimi të fakteve dhe prezantimit të arsytiveve të kërkuara.

Gjykata mund të autorizojë poligaminë në një vendim të bazuar, i cili nuk është i hapur për të apeluar një herë atë vendos ekzistencën e një arsytimi objektiv dhe të

⁸⁹BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁹⁰BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

jashtëzakonshëm dhe vihet në zbatim kushte që përfitojnë gruan e parë dhe fëmijët e saj.⁹¹

Neni 45

Kur gjykata konfirmon në diskutime se vazhdimi i marrëdhënies bashkëshortore është i pamundur, dhe ku gruaja, burri i së cilës dëshiron të marrë një grua tjetër vazhdon në kërkesën e saj për divorc, gjykata përcakton një shumë të parave që korrespondojnë me të drejtat e plota të gruas së parë si si dhe ata të fëmijëve të tyre që ai kërkohet t'i mbështesë.

Burri duhet të paguajë shumën e caktuar të parave brenda një afati maksimal prej shtatë ditësh. Pas paraqitjes së shumës së nevojshme të parave, gjykata lëshon dekretin e divorcit. Ky vendim nuk është i hapur për apel sa i përket shpërbërjes së marrëdhënies martesore.

Mos dorëzimi i shumës së nevojshme të parave brenda afatit të caktuar konsiderohet si tërheqje e petitionit të autorizimit të poligamisë. Nëse burri vazhdon në petitionin e tij të autorizimit të poligamisë, dhe gruan së cilës ai dëshiron të bashkohet me një bashkëshorte refuzon të pajtohet dhe nuk kërkon divorc, gjykata automatikisht zbaton procedurën e ndryshimeve të pa konkurrueseje në nenet 94 dhe 97.⁹²

Neni 46

Nëse kërkesa e autorizimit të poligamisë është dhënë, martesa me gruan e ardhshme nuk mund të lidhet derisa gjyqtarja ta ketë njoftuar atë se burri kërkues është tashmë i martuar dhe ajo është pajtuar për këtë.⁹³

⁹¹BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁹²BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁹³BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

Ky njoftim dhe pëlqim regjistrohen në një raport zyrtar.⁹⁴

Irakut - Kushtetuta e përkohshme irakiane nga viti 1990 e përkufizon këtë vend si republikë popullore demokratike qëllimi i së cilës është ndërtimi i shtetit unik arab dhe sistemit socialist (neni 1). Populli është burim i pushtetit dhe legjitimitetit (neni 2) kurse Islami është religjioni shtetëror (neni 4). Liria e besimit dhe e ritualeve fetare është e garantuar në pajtim me dispozitat e kushtetutës dhe ligjit dhe në pajtim me rendin publik dhe moralin. (neni 25).

E drejta e shariatit për myslimanët është relevante në fushën e statusit personal dhe është në kompetencë të gjykatave të shariatit. Sheriati gjithashtu është njëri prej burimeve të Kodit Civil nga viti 1951 të ndërtuar nën ndikimin e juristit egjiptian Abdurrezak Senhurit.⁹⁵

Sa i përket poligamisë në ligjin për familje qëndron kështu:

Ligji Nr. 188, i vitit 1959,

Ligji për familjen, i ndryshuar dhe plotësuar.

Neni 3:

Martesa është kontratë në mes burrit dhe gruas e legjitimuar, e cila për qëllim ka krijimin e lidhjes së përbashkët jetësore dhe familjare.

Kur realizohet lidhja martesore të dy palët marrin përsipër përgjegjësit martesore.

Premtimi për martesë është leximi i Fatihës dhe fejesa nuk konsiderohet kontratë martesore

Nuk lejohet martesa me më shumë se një grua, përpos se me leje të gjykatësit, ku për dhënien e kësaj leje kushtëzohet plotësimi i dy kushteve:

⁹⁴BOOK ONE: OF MARRIAGE - Title Three: Of Marriage Impediments - Chapter II: Of the Temporary Impediments - THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004

⁹⁵Muhamed Abdulxhevad Muhamed, Razvoj zakonodavstva u islamskom svijetu s posebnim osvrtom na posljednji period osmanskog hilafeta, nga arabishtja Fikret Karčić, Islamska misao, nr. 61 (Janar 1984), fq. 25.

Bashkëshorti të ketë mundësi materiale për ta mbështetur bashkëshorten.

Të ketë një interes të legjitimuar.

Nuk lejohet martesë me më shumë se një grua nëse ekziston frika për padrejtësi në mes bashkëshortëve, vlerësimi për këtë i mbetet gjykatësit.

Çdokush që organizon kontratë martesore me më shumë se një grua në kundërshtim me paragrafi 4 dhe 5 dënohet me një vite heqje lirie ose me pagesë që nuk e kalon më shumë se 100 dinar ose me të dyja.

Përrjashtim nga dispozitat e paragrafi 4 dhe 5 është se lejohet martesë me më shumë se një grua nëse ka për qëllim martesën e të vejave.⁹⁶

3.1.3. Shtete Islame që e ndalojnë poligaminë

Tunizia - Kushtetuta tuniziane nga viti 1991 në preambulë proklamon vullnetin e popullit të Tunizisë që të mbetet, ndër të tjera, besnik mësimi të Islamit. Neni 1 i kësaj kushtetute e shpall Islamit për religjion shtetëror. Liria e besimit është e garantuar me kusht që mos ta prish rendin publik (neni 5). Feja e kryetarit të shtetit është Islami (neni 38). Pasoja pozitive-juridike i këtyre dispozitave është që sheriati përbën burimin material të kushtetutshmërisë për statusin personal dhe ka ndikim të caktuar në degët tjera të të drejtës privat

Ligji tunizian ndalon rreptësisht poligaminë në bazë të Kapitullit 18 të Kodit të Gjendjes Personale, të rishikuar me Ligjin Nr. 70 të vitit 1958. Kapitulli 18 i Kodit të statusit personal parasheh që çdo individ që merret me bashkimin e martesës para zgjidhjes së martesës së tyre të mëparshme / aktuale, sanksionohet me një vit burgim dhe / ose gjobë, edhe nëse martesë e parë ose martesë e re nuk ishin kontraktuar në përputhje me ligjin. Partneri / bashkëshorti tjetër i përfshirë në poligaminë dënohet me të njëjtat sanksione.⁹⁷

⁹⁶1959" السنة "188 رقم الشخصية رقم - و تعديلاتهقانون الأحوال الشخصية رقم "188" السنة "1959 - <https://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opensslpdf.pdf?reldoc=y&docid=5c76654f4e> marur me datë 15.12.2019

⁹⁷Tunisian Family Law - British Embassy Tunis faqe 6.

Turqia - Në Turqi në mars dhe prill 1924 janë nxjerr tri ligje të cilat e kanë abroguar sheriatin dhe institucionet e lidhura me të. Ligji nr. 431 nga 3 mars 1924 e ka hequr hilafetin, institucionin më të lartë islam fetaro-politik. Ligji nr. 429 i shpallur po atë ditë ka hequr kancelarinë e shejh'ul-islamit, si autoritetin më të lartë për shpjegimin e dispozitave të shariatit, derisa ligji nr., 469 nga 8 prilli 1924 i abrogoi gjykatat shariatike.⁹⁸ Vendin e shariatit e kanë plotësuar kodifikimet e receptura evropiane (Kodi Civil zviceran, Kodi Penal italian, Kodi gjerman për Procedurën Penale etj.).⁹⁹

Parimi i shekullarizimit (laik) është pranuar si një prej parimeve bazore të Republikës dhe si i tillë do të futet në të gjitha kushtetutat e Turqisë. Ndërkaq, është e njohur që ekzistojnë perceptime të ndryshme të këtij parimi dhe në lidhje me këtë pozicioni i ndryshëm i fesë në shtetet të cilat e kanë pranuar si bazë e rregullimit të raporteve ndërmjet pushtetit fetar dhe politik. Në disa vende parimi i shekullarizimit i jep fesë pavarësi nga pushteti shtetëror dhe lirinë e veprimit, në disa të tjera e marginalizon fenë dhe ia nënshtron pushtetit shtetëror. Nga vetë miratimi i parimit të shekullarizimit në Turqi, pushteti nuk është ndarë nga Islami, por ka vazhduar ta rregullojë dhe kontrollojë manifestimin e tij. Në aspektin institucional, për shembull, me çështjet islame në Turqi prej vendosjes së Republikës i udhëheq në trup shtetëror, që sot quhet Kryesia e Çështjeve Fetare (Diyanet işleri başkanlığı), derisa me bashkësitë jomyslimane udhëheqin prijësit e tyre. Duket se Islami është së tepërmi faktor shoqëror i fuqishëm në vendet myslimane, që të mund t'i jepet autonomia.

Kushtetuta në fuqi e Republikës Turke nga viti 1982, në nenin 2, e përkufizon këtë vend si shtet demokratik, shekullar dhe social në të cilën dominon ligji, koncepti i paqes publike, solidariteti nacional, të drejtat njerëzore dhe përkushtimi nacionalizmit të Ataturkut. Këto karakteristika të Republikës, duke kyçur edhe shekullarizimin, nuk mund të ndryshohen dhe as që në këtë pikëpamje mund të shtrohen amendamente (neni 4). Neni 24 garanton lirinë e ndërgjegjes dhe besimit. Rituale, shërbimet fetare dhe ceremonitë mund të kryhen lirisht me kusht që mos të shkelen dispozitat e nenit 14 të Kushtetutës. (Neni 14 ndalon abuzimin me të

⁹⁸Binaz Toprak, *Islam and Political Development in Turkey*, Leiden: E. J. Brill, 1981, fq. 46-48.

⁹⁹K. Lipstein, *The Reception of Western Law in Turkey*, *Annales de la Faculte de droit d Stamboll*, no. 6/ 1956, fq. 11-26.

drejtat dhe liritë themelore dhe kërcënon me sanksione ligjore ata të cilët do të provonin, ndër të tjera, të vendosin sistemin e pushtetit të bazuar në konceptet dhe idetë e religjionit apo sektit.) Neni 24 më tej cek që askujt nuk i lejohet ta përdorë apo abuzojë fenë ose ndjenjat fetare ose gjerat të cilat feja i konsideron të shenjta, në cilëndo mënyrë, me synim të ndikimit personal apo politik, ose për madje për themelimin të pjesëshëm të sistemit shoqëror, ekonomik, politik apo juridik të shtetit në baza fetare.

Funksioni i të gjitha këtyre dispozitave është të sigurojnë mbrojtjen kushtetuese për shekullarizimin si ideologji dhe shtetit shekullar si model të rregullimit të marrëdhënieve të autoritetit fetar dhe politik, ashtu si i kanë kuptuar elitat sunduese, pa marrë parasysh në ndryshimet e mundshme në shoqërinë turke. Përjashtimi i sheriatit nga fusha publike është njëri nga parimet e Republikës kurse çdo përpjekje e ndryshimit të gjendjes së këtillë është kundër kushtetues. Në kodin penal të Turqisë është dënuar martesë me më shumë se një grua dhe atë si në vijim:

Neni 230

Një person i cili martohet me një person tjetër edhe pse ai / ajo është martuar legalisht në atë kohë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Çdo person që zyrtarisht martohet me një person të njohur si i martuar me një person tjetër edhe pse është bachelor, dënohet sipas parashikimeve të nën-paragrafit.

Kushdo që përpiqet të martohet duke fshehur identitetin e tij, dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit.

Statuti i parashkrimit për veprat penale të përcaktuara në paragrafët e mësipërm fillon të dalë nga data e vendimit që përcakton anulimin e martesës.

Çdo çiftë që martohen duke rregulluar ceremoninë fetare pa kryer transaksione zyrtare martesë, dënohen me burgim nga dy muaj deri në gjashtë muaj. Si veprimi publik ashtu edhe dënimi i shqiptuar, zvogëlohet me të gjitha pasojat e tij kur kryhet ceremonia e martesës civile.

Çdo person që zhvillon një ceremoni martesore fetare pa parë vërtetimin e martesës, dënohet me burgim nga dy muaj deri në gjashtë muaj.¹⁰⁰

Kurse sipas të drejtës civile turke në të drejtën familjare thuhet:

Neni 130

Kushdo që dëshiron të rimartohet duhet të dëshmojë se martesa e tyre e mëparshme ka përfunduar.

Në raste të mungesës¹⁰¹

Neni 131

Nëse nuk janë prezent njëri prej çifti bashkëshortor në gjyq, gjyqi nuk bënë shkurorëzim, dhe asnjëri nuk mund që të rimartohet.¹⁰²

3.2. Poligamia në ligjet e shteteve Evropiane

3.2.1. Anglia

Poligamia është një institucion martesor me më shumë se një bashkëshort në të njëjtën kohë, i cili është i ligjshëm dhe i njohur në disa vende të botës.¹⁰³ Një martesë poligamia mund të ndodhë që të përbëjë një martesë të madhe, e cila është akti i kundërligjshëm i një martese të një personi që më është i martuar me një person tjetër.

¹⁰⁰Criminal Code Law Nr. 5237 - Passed On 26.09.2004 - (Official Gazette No. 25611 dated 12.10.2004)- FIRST VOLUME THIRD CHAPTER - Offenses Against Community - EIGHTH SECTION -Offenses Against Family Order – 230 ARTICLE

¹⁰¹TÜRK MEDENİ KANUNU - İKİNCİ KİTAP AİLE HUKUKU - İKİNCİ AYIRIM - EVLENME EHLİYETİ VE ENGELLERİ- NİSAN 2018

¹⁰²TÜRK MEDENİ KANUNU - İKİNCİ KİTAP AİLE HUKUKU - İKİNCİ AYIRIM - EVLENME EHLİYETİ VE ENGELLERİ- NİSAN 2018

¹⁰³Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 8

Bigamy është një shkelje ligjore në Angli, sipas nenit 57 të veprave penale kundër personit Akti 1861 (Offences against the Person Act - OaPA 1861). Për më tepër, është gjithashtu një martesë e pavlefshme sipas nenit 11 (b) të Matrimonial Causes Act1 (MCA 1973). Të dy pjesët janë të zbatueshme për rastet në lidhje me martesat e lidhura në Angli ose Irlandë dhe rastet në lidhje me një temë britanike.¹⁰⁴

Si rrjedhim, një martesë poligamie e lidhur në Angli nën ligjin anglez gjithmonë do të përbëjë një bigamy dhe do të jetë e pavlefshme dhe një vepër penale.

Hyde v. Hyde normalisht shihet si çështja përcaktuese e institucionit të martesës pasi vendosi mirëkuptimin modern dhe përcaktimin ligjor të martesës. Në këtë rast, Lord Penzance deklaroi si pikëpamje të krishterimit, se martesë është bashkimi për jetën e një burri dhe një gruaje, çdo formë tjetër është e përjashtuar.¹⁰⁵ Monogamia është një parim themelor në sistemin juridik anglez.

Lord Penzance arriti në përfundimin se një martesë poligamie, megjithëse është e vlefshme martesë në respekt të parimit të lex loci celebris, nuk do të njihet si një martesë e vlefshme në Angli.¹⁰⁶

Qëndrimi ndaj martesave poligamie ndryshoi, gjë që çoi në reforma ligjore. Matrimonial Proceedings (Polygamous Marriages) Act 1972 (MPA 1972) ndryshoi ligjin e martesave poligamie. Para këtij akti ligji ishte bazuar në vendimin në Hyde v. Hyde.¹⁰⁷ Seksioni përkatës 4 in MPA 1972 u shfuqizua më vonë nga MCA 1973, që është akti përkatës në fuqi edhe sot, duke deklaruar efektin civil të një martesë poligamie. Sipas nenit 11 (d) MCA 1973 një martesë poligamie është e pavlefshme nëse njëra nga palët është me vendbanim në Angli dhe martohet në mënyrë të ligjshme në kohën e martesës së dytë. Me fjalë të tjera, nëse një bashkëshort është me vendbanim në Angli, por përfundon një martesë poligamie jashtë vendit, ajo martesë do të jetë e pavlefshme në Angli.

¹⁰⁴ Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 8

¹⁰⁵ Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 8

¹⁰⁶ Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 9

¹⁰⁷ Hussain v. Hussain (1983) Fam. 26 at 31.

Prandaj, vendbanimi është përcaktori kryesor, pasi të tjerët janë të lirë të kryejnë martesë poligamie në përputhje me ligjet e tyre personale ose fetare, nëse martesë bëhet jashtë Anglisë. Komisioni Ligjor deklaroi se ata nuk rekomandojnë ndryshimin e ligjit për njohjen e martesave në të vërtetë poligamie të lidhura jashtë vendit nga një vendor anglez pasi kjo do të thoshte trajtim diferencial dhe nuk do të aprovohej përgjithësisht, në krahasim me personat që hyjnë në martesë në Angli. Sipas seksionit 11, efekti i një martesë të pavlefshme siç thuhet në nenin 11 (d) do të zbatohet vetëm për martesat e lidhura pas 31 korrikut 1971.

Vende të ndryshme kanë rregulla të ndryshme në lidhje me vlefshmërinë thelbësore dhe poligamia bie brenda qëllimit të kësaj. Nëse martesë ka një vlefshmëri zyrtare dhe vlefshmëri thelbësore, ajo do të njihet si një martesë e vlefshme në Angli. Si rrjedhim, martesat poligamie të kontraktuara jashtë vendit, ku asnjë palë nuk është me vendbanim në Angli, përgjithësisht do të njihet në Angli nëse është e ligjshme sipas ligjit personal dhe vendit të festimit. Pavarësisht, njohja nuk shtrihet në të gjitha fushat. Njohja mbulon vetëm përfitimet e mirëqenies, por jo qëllimet e pensionit, imigracionit ose shtetësisë.¹⁰⁸

3.2.2. Gjermania dhe Franca

Gjermania është një vend i së drejtës civile, me një kod të detajuar civil, Bürgerliches Gesetzbuch (BGB). Të drejtat më të rëndësishme përcaktohen në Grundgesetz (GG). Art. 6 GG vendos pikëpamjen gjermane mbi martesën dhe familjen. BVerfG në "Spanierentscheidung" ka deklaruar se arti. 6 GG përbën një të drejtë themelore për çdo person që të martohet me dikë që ata vetë e kanë zgjedhur lirisht. Monogamia shihet si formë e përshtatshme e bazuar në koncepte morale dhe për këtë arsye, në përgjithësi, vetëm martesat monogamie do të mbulojnë plotësisht nga arti. 6 GG. Pyetja është nëse institucionet e tjera të martesës janë të mbuluara nga kjo e drejtë themelore e cila është debatuar disa herë në gjykatat gjermane. Aftësia materiale për të lidhur një martesë në Gjermani është sipas nenit 13. Einführungsgesetz zum Bürgerlichen Gesetzbuch (EGBGB) e përcaktuar me ligjin personal bazuar në kombësinë si lex patriae. Nëse një person ka disa kombësi në përputhje me artin. 5 EGBGB, faktorë të tjerë

¹⁰⁸Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 10

do të përcaktojnë ligjin personal.¹⁰⁹ Ligji personal do të përcaktojë gjithashtu pasojat e shkeljes që mund të çojnë në një martesë të pavlefshme. Nëse dy bashkëshortë kanë kombësi të ndryshme, ligji personal do të përcaktojë vetëm vlefshmërinë materiale të bashkëshortit

Bigamy është i ndaluar sipas neni 1306 BGB. Si rrjedhim, një person i detyruar me ligjin gjerman është i ndaluar të lidhë një martesë tjetër, nëse ai person tashmë është martuar me ligj dhe martesa e parë nuk është shpërbërë. Ndalimi i bigamisë mbron parimin e monogamisë që është vendosur në art. 6 GG. Kjo do të thotë se një poligamie në të vërtetë martesë kurrë nuk mund të lidhet në Gjermani sipas ligjit gjerman. A martesë që është famëkeqe sipas 1306 6 BGB është e pavlefshme sipas neni 1314 BGB. Kjo do të thotë që martesë e dytë është e efektshme derisa të shpallet e pavlefshme. Parimi themelor i monogamisë përcaktohet më tej në neni 172 të Strafgesetzbuch (StGB) ku bigamy shprehet si vepër penale. Që neni 172 i StGB të jetë e zbatueshme, martesë duhet të ketë ndodhur në Gjermani ose duhet të përfshihet një subjekt gjerman. Nëse martesë festohej jashtë vendit nga të huajt, ajo nuk do të përbëjë vepër penale në Gjermani pasi Gjermanisë i mungon juridiksioni sipas neni 7 StGB.

Ndalimi i bigami është i zbatueshëm për të gjitha martesat që ndodhin në Gjermani ose ku është përfshirë një subjekt gjerman, pa marrë parasysh vendin e martesës. Ndalimi ka një efekt të dyfishtë pasi një shtetas gjerman nuk mund të përfundojë me një martesë poligamie. Për më tepër, një shtetas gjerman nuk mund të lidhë një martesë poligamie me një të huaj të martuar. Martesat poligame të ndodhura në një vend ku është legal, përgjithësisht, do të njihen. Nëse të dy ligjet personale lejojnë poligaminë, nuk ka shkelje në vlefshmërinë materiale. Nëse martesë poligamike "importohet" në vend, nuk do të përbëjë të drejtën për t'u martuar me një bashkëshort tjetër në Gjermani. Martesë poligamie është e kufizuar në skicën e saj kur hyn në vend. Kjo do të thotë që një bashkëshort mund të kryejë një martesë tjetër në Gjermani pas një divorci nga martesë poligamie. Për më tepër, martesë me persona të tjerë nuk lejohet në Gjermani, bazuar në ndalimin e bigamy-t të zbatueshëm si *lex loci celebris*.¹¹⁰

¹⁰⁹MüKoBGB (2017), art. 5 EGBGB, Rn 2-12.

¹¹⁰Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017 p. 21

Vende të tjera në Evropë gjithashtu luftojnë me poligaminë. Gjobat dhe dënimet me burg, në disa raste deri në shtatë vjet, janë normë për ata të dënuar për poligaminë në Evropë. Një përjashtim është Norvegjia. Në Francë, martesë me më shumë se një person dënohet me një vit burg dhe me gjobë prej 45,000 Euro (gati 60,000 dollarë).

Nene 147

Askush nuk mund të kontraktojë një martesë të dytë para shpërbërjes të së parës.

3.2.3. Shqipëria

Republika e Shqipërisë qysh në fillim të shekullit 20 e kishte kodifikuar të drejtën e saj civile. Kështu, në vitin 1929, në Mbretërinë e atëhershme shqiptare është aprovuar Kodi Civil, i njohur ndryshe edhe si Kodi Civil i Zogut, apo edhe si Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare. Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare është hartuar kryesisht duke u bazuar në Kodin Civil Francez. Ky kod në strukturën e tij është i ndarë në 4 libra (pjesë). Libri i Parë ka të bëjë me Personat dhe Familjen, Libri i Dytë me Trashëgimin, Libri i Tretë me Sendet, zotimin e tyre si dhe modifikimet, kurse Libri i Katërt me Mënyrat e fitimit dhe të transmetimit të zotimit dhe të të drejtave të tjera mbi sendet. Kodi në vetvete përmban 2047 nene, pa përfshirë edhe pjesën e Ligjit për zbatimin e Kodit Civil, i cili përmban edhe 64 nene. Siç u tha më lart, dispozitat të cilat i kanë rregulluar marrëdhëniet familjare në këtë kod gjenden në pjesën e parë të tij, përkatësisht në Librin e parë, i cili ka të bëjë me Personat dhe Familjen. Në lidhje me martesën, Kodi përcakton se “nuk ekziston martesë kur mungon” Po ashtu, sipas këtij Kodi parashihet edhe mosha minimale për martesë e që për mashkullin është 18 vjeç, kurse për femrën është 16 vjeç. Kodi i jep përparësi parimit të monogamisë në martesë, duke parashikuar se nuk mund të lidhet një martesë tjetër, para se të zgjidhet ajo e mëparshmeja

Në Kodin Civil të Shqipërisë të vitit 1929, në rastin e shkurorëzimit janë parashikuar një mori pasojash dhe efektësh. Në fakt, Pjesa e Parë apo Libri i Parë i Kodit përmban dispozitat mbi familjen dhe të drejtën familjare, por rrjedhimisht edhe mbi të drejtën martesore.

Martesa është institucioni kryesor që i paraprin familjes. Familja përbën bashkimin e personave që për shkak të lidhjes së martesës, gjinisë, ose birësimit, janë të lidhur mes tyre në marrëdhënie psikologjike, morale, ekonomike dhe juridike; jetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare dhe mbajnë para shoqërisë përgjegjësi shoqërore për njëri-tjetrin.¹¹¹ Në kodin familjarë të Republikës së Shqipërisë çështja e martesës parashihet si më poshtë:

Neni 7:

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.¹¹²

Neni 9 :

Nuk mund të lidhë martesë të re personi që është martuar, derisa martesa e mëparshme nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur.¹¹³

Neni 41:

Martesa e lidhur gjatë vazhdimin të një martese të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve është e pavlefshme.¹¹⁴

Duke u nisur nga nenet e më larta e kuptojmë se poligamia edhe në Republikën e Shqipërisë është e ndaluar dhe e pa pranueshme.

¹¹¹Santhipi, Begeja: “E drejta familjare e RPS të Shqipërisë”. Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1985, fq. 4.

¹¹²KODI I FAMILJES L I G J Nr.9062, datë 8.5.2003 - MARTESA - Moshë e lidhjes së martesës

¹¹³KODI I FAMILJES L I G J Nr.9062, datë 8.5.2003 – MARTESA - Ndalimet për lidhjen e martesës

¹¹⁴KODI I FAMILJES L I G J Nr.9062, datë 8.5.2003 - PAVLEFSHMËRIA E MARTESËS - Shkaqet e pavlefshmërisë

3.2.4. Kosova

Republika e Kosovës edhe pse ndër shtetet më të reja për nga pavarësia e saj ka arritur që për një kohë të shkurt të rregulloj një numër të madh të ligjeve posaçërisht asaj civile prandaj te familja, martesë ajo e ka përshkruar si më poshtë:

Neni 14. Martesa

Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.

Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.¹¹⁵

Neni 19.

Askush nuk mund të lidhë martesë të re, përderisa martesë e parë nuk pushon juridikisht.¹¹⁶

Neni 244

Kushdo që lidh martesë tjetër derisa është i martuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

Kushdo që lidh martesë me personin për të cilin e di se është i martuar, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Nëse pas kryerjes së veprës penale nga ky nen, martesë e mëparshme nuk është më e vlefshme, është prishur ose është ndërprerë, ndjekja penale për veprën nga ky nen nuk fillohet, e nëse ndjekja është filluar duhet të ndërpritet.¹¹⁷

¹¹⁵LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS- PJESA E DYTË FEJESA DHE MARTESA - UNITED NATIONS United Nations Interim Administration Mission in Kosovo fq. 4

¹¹⁶LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS- PJESA E DYTË FEJESA DHE MARTESA - UNITED NATIONS United Nations Interim Administration Mission in Kosovo fq. 5

Në Republikën e Kosovës në kodin civil mbi të drejtën familjare për çështjen e martesës lejojnë martesën e vetëm një burri me një grua dhe martesë të dytë nuk e konsiderojnë si të ligjshme por edhe me kodin penal për ata të cilat bëjnë një martesë me më shumë se një grua kanë paraparë dënim deri me një vite burg.

3.3. Poligamia në të drejtën familjare në Maqedoni

Një nga vlerat themelore kryesore të rendit kushtetues së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit, që njihen me të drejtën ndërkombëtare dhe përcaktohen nga Kushtetuta. Në përputhje me nenin 9 të Kushtetutës: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.”¹¹⁸

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në nenin 50 të Kushtetutës parashikohet se çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës.

Përveç parimit të barazisë, Kushtetuta në nenin 110 në mënyrë eksplicite e ndalon diskriminimin e qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, nacionale, sociale dhe politike.

Ne do ndalim mbi atë që edhe e kemi temën mbi të drejtën e familjes respektivisht mbi martesën se si është para parë nga ana e ligjvënësit.

¹¹⁷KODI NR. 04/L-082 PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS - KAPITULLI XXI VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES fq. 102

¹¹⁸Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë - Liritë dhe të drejtat civile dhe politike - Nr 08-4642/1 - 17 nëntor 1991

Neni 6:

Martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vendimit të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në bazë të barazisë së tyre, respektit reciprok dhe ndihmës së ndërsjellët.¹¹⁹

Neni 17:

Nuk mund të lidh martesë personi, përderisa martesa e mëparshme nuk i ka pushuar¹²⁰

Duke pasur parasysh këta dy nene të ligjit për familje shohim se martesa e lejuar në RMV konsiderohet martesa e një burri me një grua d.m.th. martesë monogamie dhe e cila nuk mund të lidhet nëse njëri prej këtyre dyve ka martesë të ma hershme prej të cilës nuk e ka të pushuar. Por përpos kësaj kemi edhe të rregulluar në kodin penal për çështjen e martesës nëse ndokush ka të lidhura dy martesa ku thuhet :

Neni 195:

Ai i cili lidhë kontratë martesore, edhe pse më është i martuar do të dënohet me burg prej 3 muaj deri në 3 vite.

Me dënim nga paragrafi 1 do të dënohet edhe ai që do të lidhë martesë me një person për të cilin e di që është në martesë.¹²¹

¹¹⁹Ligji për familje-, Gazeta zyrtare e RMV – së nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14 и 104/15,

¹²⁰Ligji për familje-, Gazeta zyrtare e RMV – së nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14 и 104/15,

¹²¹КРИВИЧЕН ЗАКОНИК - Глава дваесетта -КРИВИЧНИ ДЕЛА ПРОТИВ БРАКОТ, СЕМЕЈСТВОТО И МЛАДИНАТА – Двобрачност „Службен весник на Република Македонија" број 80/99... с. 89

Në RMV vetmja martesë e njohur nga ligjvënësi ishte martesë me një grua dhe një burri deri para disa viteve kur filloi të debatohet për martesat të LGBT për të cilën nëse lejohet martesë e tillë atëherë vetëm nëneni 6 i ligjit për familje bie poshtë për shkak se aty përkufizohet martesë mes një Burri dhe Gruas dhe nëse arrihet ky ndryshim për martesën e të njëjtit gjini atëherë është e logjikshme që të parashihet edhe një nen për lejimin e poligamisë. Po ashtu rreth 12 për qind nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të lindur të gjallë në Maqedoni në vitin 2016 kanë lindur jashtë martesë, tregojnë të dhënat e Eurostat.¹²²

3.4. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) (emri zyrtar Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore) është një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Evropë. Hartuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës, atëherë i sapo formuar, konventa hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë nënshkrues të Konventës dhe anëtarë të rinj duhet të ratifikojnë këtë konventë në mundësinë më të parë. Si pasojë e amendimit nga Protokollin 11, tashmë Konventa përbëhet nga tre pjesë. Të drejtat dhe liritë kryesore të njeriut mund të gjenden në Seksionin I, që përbëhet nga artikujt 2 deri në 18. Seksioni II, që përmban artikujt 19 deri në 51, krijon Gjykatën dhe parashtron rregullat e funksionimit të kësaj të fundit. Seksioni III përmban dispozita të ndryshme përmbyllëse.

Seksioni I përmban liritë e njeriut ku bënë pjesë privatësia, familja dhe martesë atë që i takon një njeriu si e drejtë e tij kështu që në:

Neni 8

Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij.

¹²²<https://www.botasot.info/maqedonia/935245/cdo-i-teti-femije-ne-maqedoni-eshte-jashte-martese-ne-be-cdo-i-dyti/> e marur me datë 20.12.2019

Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.¹²³

Neni 12 :

Që nga mosha e martesës, burri dhe gruaja kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.¹²⁴

Në nenin 12 të KEDNJ për çështjen e martesës është përdorur emrat burrë dhe gruaje në njëjës duke e aluduar në martesë monogamie e cila duhet të rregullohet në bazë të ligjeve kombëtare apo të shteteve në të cilën jetojnë apo martohen.

¹²³Konventa e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore amenduar sipas Protokollit n° 11 - Të DREJTAT DHE LIRITÀ - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare fq. 6 - 1 nëntor 1998.

¹²⁴Konventa e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore amenduar sipas Protokollit n° 11 - Të DREJTAT DHE LIRITÀ - E drejta për martesë fq. 7 - 1 nëntor 1998.

KAPITULLIV

4. ANKETA

Anketa në vazhdim është bërë për të pasur një pasqyrë më të lehtë rreth temës të cilën e kemi trajtuar këtu, dhe kjo anketë është realizuar në disa grupe nga vende të ndryshme dhe religjioneve të ndryshme. Pjesa që është bërë në vendet arabe është bërë nga disa studentë të cilët studiojnë atje. Anketa e tyre është zhvilluar gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të viti 2019, kurse anketën e bërë në RMV e kam bërë vetë gjatë muajit janar të viti 2020 dhe atë në qytetin e Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Manastirit, Kërçovës, Velesit, Shtipit.

Anketa është zhvilluar si më poshtë:

4.1. Anketë me arabë

Te arabët anketa është zhvilluar te pjesëtarë myslimanë dhe atë në 50 çifte nga mosha të ndryshme. Në mesin tonë kur përmenden vendet arabe, menjëherë shkon mendja në një vend ku burri bën gjithçka të dojë dhe gruaja nuk ka asnjë të drejtë, prandaj në vend të parë kam marrë këto vise:

Egjipt

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore ?

100 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

70 % e burrave të martuar dhe 50 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

3. A është i lirë ta praktikojë kur të dojë ?

50 % e burrave të martuar dhe 20 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

37 % e burrave të martuar dhe 80 % e grave u përgjigjën me "Po".

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

85 % e burrave dhe 95 % e grave u përgjigjën "Po".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

62 % e burrave dhe 90 % e grave u përgjigjën me "Po".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

50 % e burrave dhe 97 % e grave u përgjigjën me "Po".

Arabia Saudite

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore ?

100 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

90 % e burrave të martuar dhe 70 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

3. A është i lirë t'a praktikojë kur të dojë ?

95 % e burrave të martuar dhe 60 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

75 % e burrave të martuar dhe 55 % e grave u përgjigjën me "Jo".

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

50 % e burrave dhe 50 % e grave u përgjigjën "Po".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

80 % e burrave dhe 50 % e grave u përgjigjën me "Jo".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

50 % e burrave dhe 90 % e grave u përgjigjën me "Po".

Emiratet e Bashkuara Arabe

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore ?

75 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

80 % e burrave të martuar dhe 67 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

3. A është i lirë ta praktikojë kur të dojë ?

97 % e burrave të martuar dhe 37 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

99 % e burrave të martuar dhe 53 % e grave u përgjigjën me "Jo".

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

85 % e burrave dhe 95 % e grave u përgjigjën "Jo".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

84 % e burrave dhe 70 % e grave u përgjigjën me "Jo".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

48 % e burrave dhe 77 % e grave u përgjigjën me "Jo".

4.2. Anketa me banorë që jetojnë në RMV

Të krishterë

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore?

100 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

90 % e burrave të martuar dhe 100 % e grave të martuara u përgjigjën me "Jo."

3. A është i lirë ta praktikojë kur të dojë ?

90 % e burrave të martuar dhe 100 % e grave të martuara u përgjigjën me "Jo."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

////////////////

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

85 % e burrave dhe 99 % e grave u përgjigjën "Po".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

90 % e burrave dhe 90 % e grave u përgjigjën me "Po".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

60 % e burrave u përgjigjen me Nuk e di

97 % e grave u përgjigjën me "Po".

Ateistë (këtu kemi vetëm 20 çifte)

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore ?

100 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

100 % e burrave të martuar dhe 100 % e grave të martuara u përgjigjën me "Jo."

3. A është i lirë ta praktikojë kur të dojë ?

95 % e burrave të martuar dhe 99 % e grave të martuara u përgjigjën me "Jo."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

//////////

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

95 % e burrave dhe 99 % e grave u përgjigjën "Po".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

99 % e burrave dhe 100 % e grave u përgjigjën me "Po".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

95 % e burrave dhe 97 % e grave u përgjigjën me "Po".

Myslimanë

1. Martesa poligamia apo monogamia është thelbësore ?

85 % e të martuarve u përgjigjën se monogamia është thelbësore

2. A është martesa me të dytën e drejtë legjitime e burrit ?

75 % e burrave të martuar dhe 63 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po."

3. A është i lirë ta praktikojë kur të dojë ?

65 % e burrave të martuar dhe 83 % e grave të martuara u përgjigjën me "Jo."

4. A e kanë keqpërdorur burrat të drejtën e tyre për martesë me më shumë se një grua ?

30 % e burrave dhe 75 % e grave të martuara u përgjigjën me "Po".

5. A është e vërtetë se gratë e refuzojnë kategorikisht idenë e të qenit grua e dytë ?

85 % e burrave dhe 78 % e grave u përgjigjën "Po".

6. A ndihet gruaja e parë e tradhtuar nëse burri i saj martohet me një të dytë?

85 % e burrave dhe 93 % e grave u përgjigjën me "Po".

7. A është e vërtetë se burri e ka të pamundur drejtësinë mes grave të tij ?

67 % e burrave dhe 88 % e grave u përgjigjën me "Po".

PËRFUNDIME

Nga puna e sipërme lirisht mund të themi se poligamia ka luajtur një rol të veçantë në jetën shoqërore, edhe përkaj asaj që njerëzit çdoherë e drejtojnë gishtin ka myslimanët dhe Islami kur përmendet martesë me më shumë se një grua, por në realitet shohim se Islami e ndaloi përbuzjen e gruas në të kaluarën në të cilën ajo ishte e barabarta me asgjë, përpos asaj e pamë që gjatë punimit nuk ishte vetëm Islami që e praktikonte martesën me më shumë se një grua, por të njëjtën e gjenim edhe te hinduset, hebrejt po edhe te të krishterët, posaçërisht ata që jetonin në Afrikë. Ajo që u dha gjatë këtij punimi është kuptimi i asaj që Islami e ka lejuar martesën me më shumë se një grua por nuk e ka bërë obligim.

Anketën të cilën e kemi pjesë të këtij punimi na mundësoi që të shohim mendime dhe pikëpamje të ndryshme rreth poligamisë dhe atë varësisht nga vendi ku jetojnë, pra nëse shohim viset arabe shohim se te ato poligamia është e pranueshme dhe si e tillë konsiderohet e drejtë legjitime e burrit i cili nuk e ka keqpërdorur këtë të drejtë dhe po në të njëjtat vise një veprim të tillë nuk e konsiderojnë si tradhti ndaj gruas, në përjashtim të Egjiptianëve te të cilët kishim një numër të mjaftueshëm të grave dhe burrave që u përgjigjen se një veprim të tillë pra një martesë poligamie do ta bënte që bashkëshortja e parë të ndjehet e tradhtuar, poashtu edhe te drejtësia në mes bashkëshorteve shohim se janë më se të vetëdijshëm që një veprim i tillë është i vështirë për tu aplikuar kur një burrë ka më shumë se sa një bashkëshorte. Kurse nga pasqyra e anketës së bërë në RMV, kemi tjera pikëpamje për çështjen e poligamisë duke pasur parasysh se anketa është bërë në ndarje fetare dhe jo kombëtare dhe këtu shohim që përpos myslimanëve dy grupet e tjera nuk e konsiderojnë si të drejtë legjitime të burrit martesën poligamie, kurse për praktikimin e tij të anketuarit në RMV ishin të mendimit se ajo nuk është liri e bashkëshortit që të veproj sipas dëshirës së tij, por e konsideronin si të drejtët të barabartë në mes bashkëshortëve për vendosjen e një martesës poligamie, nëse do ishte e mundshme një martesë e tillë, dhe sa i përket drejtësisë po ashtu të anketuarit ishin të mendimit se është e pamundur edhe pse kishte prej atyre që u përgjigjen me nuk e di, nga

shkaku se për disa ishte edhe e pakapshme tema e poligamisë kurse të tjerët than se nuk kanë hasur në çifte të atilla prandaj u përgjigjen me Nuk e di.

Ajo që është e përbashkët e të gjithë të anketuarve ishte vetëm fakti se ishin të gjithë të një mendimit që martesë monogamie është thelbësore, kurse poligamia është sekondare e cila mund të shfrytëzohet në disa kohëra dhe vende sipas nevojës, .

Kur themi që zbritja e Kuranit dhe fjalët e të dërguarit të fundit ishin për t'ia lehtësuar jetën njerëzimit, me këtë mund të lind pyetja si e ka lehtësuar jetën Islami me lejimin e poligamisë? – për përgjigjen e kësaj do të marrim shembullin dhe atë nga dy njerëzit e parë Ademin dhe Havën dhe fëmijëve të tyre, ku vëllezërit dhe motrat pra ishin të obliguar për t'u martuar që të arrihet te shumimi i njerëzimit, çështje të cilën nëse e kthejmë në kohën moderne të cilën jetojmë do të shohim se një gjë e tillë është e shëmtuar, nga shkaku se sot kemi mundësi që të martohemi me ata që nuk kemi lidhje gjaku. E njëjta është edhe me poligaminë, ndoshta për momentin dallimi në mes dy gjinive është i vogël, por në të ardhmen edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut mundemi të kemi një ndryshim të tillë sa që numri i vajzave të jetë në rritje dhe të jetë shumë më të madhe se sa i djemve dhe për këtë duhet të ketë zgjidhje ose në të kundërtën ndodh ajo që veç se jemi bërë pjesë e një shoqërie si LGBT ose të kemi shtëpi publike për të arritur deri te kënaqësia e epsheve ose të vejat të shohin si rrugëdalje për mbijetesë marrja me prostitucion.

Nuk them se duhet të lejohet praktika e poligamisë pa asnjë kusht ose ajo që ndodh deri tash në mesin e popullatës tonë ku i riu martohet me një vajzë dhe ofiqar i tyre është një teolog që në aspektin fetar mban ritualet e fesë ndërsa po ky i ri në komunë nuk vendos kurorë dhe me këtë atij i jepet një mundësi për një martesë tjetër, pastaj do të ishte më në rregull sikur ligjvënësi të parashihte një nen për poligami me një numër të caktuar se sa tash ku kemi njerëz të martuar me dy gra dhe ku asnjëra nuk konsiderohet e kurorëzuar po përveç kësaj ajo edhe nuk ka asnjë të drejt mbi të drejtat e martesës.

Islami lejoi martesën me më shumë gra për ta mbajtur një shoqëri më të shëndoshtë ku të vejat do të gjenin përkrahje, ku nuk do të shfaqen sëmundje të ndryshme të pashërueshme, ku fëmijët do të ndjenin ngrohtësinë familjare etj.

Gjithashtu, shija e ithët që lënë disa nëpërmjet praktikave të gabuara në martesë poligamie dhe padrejtësitë që i bëhen gruas së parë, nuk ka përse të bëhen shkak për të sulmuar këtë të drejtë të përligjur nga Sheriati islam. Ajo që mund të bëjmë, është ndërgjegjësimi i dy bashkëshortëve mbi të drejtat dhe detyrat ndaj secilit, si në një martesë monogamike, ashtu edhe në një poligamie. Vetëm në këtë mënyrë mund të mënjanojmë efektet anësore që shoqërojnë një martesë të tillë.

Fund i fundit, ky është edhe sistemi jetësor - çdo gjë ka nevojë për tjetrën, në vendin dhe kohën e duhur.

REKOMANDIME

1. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të fillojë ndryshimi i Ligjit për Familje me qëllim që të jetë e paraparë edhe martesë poligame.
2. Në familjen bashkëshortore ushqimi i fëmijëve u takon prindërve dhe familjarëve të tjerë, dhe atë sipas nenit 179 të ligjit për familje (Gazeta zyrtare e RMV nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14 и 104/15,) rekomandohet që babai është përgjegjës i njëjtë për ushqimin e të gjithë fëmijët në martesën poligame, kurse nëna vetëm për fëmijët e saj.
- 3, Në nenin 181 të Ligjit për Familje (Gazeta zyrtare e RMV nr. 80/92, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14 и 104/15,) ushqimi i fëmijëve, prindërve dhe familjarëve të tjerë rekomandohet që fëmijët duhet të ju japin ushqim vetëm prindërve biologjik të tyre dhe gruas së babit që e ka në poligami por që nuk ka fëmijë.
4. Te neni 16 i ligjit për trashëgimi (Gazeta zyrtare e RM nr.47 i 12.09.1996) në pjesën e trashëgimtarëve të dytë, prindërit dhe bashkëshorti/ja paragrafi i 2 rekomandohet të jetë që pjesa e dytë e pasurisë të trashëgohet nga bashkëshortet e të vdekurit kurse nëse është gruaja e vdekura, atëherë trashëgon vetëm burri.

Gjithashtu shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan në realizimin e këtij punimi: profesoreshën e lëndës (mentoren), e cila më përkrahu për të punuar këtë temë, dhe të gjithë ata që më dhanë ndihmë në gjetjen e literaturës për çështjen e martesës në veçanti të poligamisë.

BIBLIOGRAFIA

Libra dhe revista

1. Aliu Abdulla, E drejta familjare, Prishtinë , 2007
2. Fahrudin Ebibi/ Irfan Abazi/ Taxhedin Bislimi/ Jusuf Zimeri - E drejta familjare në Islam –Shkup 2004
3. Hamude Abdulati ,Struktura familjare në Islam – Logos A Shkup 1995
4. Jusuf Kardavi Hallalli dhe Harami në Islam, Prishtinë, Logos 2002
5. Muhammed Kutub Dilemat rreth Islamit, Prishtinë 2001
6. Zejnudin Ahmed ibn Abdul Latif Zebidi Muhtesar Sahihi Buhari (përmbledhje e librit sahihi el – Buhari), Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetimit Islam , Tiranë 2015
7. Kur'an, përkthim me komentim në gjuhën shqipe nga H. Sherif Ahmeti
8. Shtjefën Gjeçovi, Editor Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtëpia Botuese Kuvendi Tiranë 1998
9. Fetih Mehdiu Sahihi Buhari, Prishtinë 2014
10. Muhamed Rashid Rida, Të drejtat e gruas në islam, Nektari - Tiranë,2006
11. Familja në qëllimet e Sheriatit: Të lexuarit në lidhje me martesën dhe çështjet e divorcit në Amerikë (الأُسرة في مقاصد الشريعة: قراءة في قضايا الزواج والطلاق في أمريكا) – titulli origjinal) Zainab Al – Alwanim 2013
12. Martesa, paratë dhe divorci në shoqërinë mesjetare islamike (الزواج والمال والطلاق في) (المجتمع الإسلامي في العصور الوسطى) Jusuf Rabuburet, Qendra e Trashëgimisë për Kërkime dhe Studime
13. Polygamy in Islam Bilal Philips & Jameelah Jones Publisher:International Islamic Publishing House; IIPH, 2005
14. Othman, N. (2006). Muslim women and the challenge of Islamic fundamentalism/extremism: An overview of Southeast Asian Muslim women's struggle for human rights and gender equality.

15. Nagata, J.A. (1984). The reflowering of Malaysian Islam : modern religious radicals and their roots. Vancouver: University of British Columbia Press. Narli, N.f. (1991). Unveiling the fundamentalist women: a case study of university students in Malaysia. Istanbul: Isis Press.
16. Moghadam, V.M. (1994). Gender and National Identity: Women and Politics in Muslim Societies. Zed Books
17. Karim, W.J.B. (1992). Women and culture: between Malay Adat and Islam. N.P: Westview Press.
18. Kamaruddin, Z. and Abdullah, R. (2008). Protecting Muslim Women against Abuse of Polygamy in Malaysia: Legal Perspective. Hawwa
19. Alexandre, M. (2007), Lessons from Islamic Polygamy: A Case for Expanding the American Concept of Surviving Spouse So As to Include De Facto Polygamous Spouses. Washington & Lee L. Rev.,. 64 (4)
20. Primjena serijatskog porodicnog prava kroz praksu serijatskog suda 1914 – 1946, Ibrahim Dananovic, Sarajevo 2014
21. Elementet themelore te jetës bashkëshortore, Muhamed Ahmed Kenan, El – Kalem Gostiver 2004
22. Wastermarck, Edvard Alexander – The history of human marriage, New York; the allerton book co... bot. V vëll. III 1992
23. Histoia e së drejtës së Sheriatit, Fikret Kaqçiq, Shkup 2003
24. E drejta Islame- burimi dhe zhvillimi, Seid Ramadan, Logos – A, Shkup 2007
25. Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë, 2010
26. Bernard Lewis, The Middle East, Weidenfeld & Nicolson, London, 1995.
27. Karen Armstrong, Muhammad A Biography of The Prophet, Harper Collins Publisher, USA, 1992.
28. Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë, 2006

29. M.Stol: Privat life in Ancient Mesopotamia, in Civilization of the Ancient near East vol I New York 1995.
30. Princh Geraldine, Private life in Ancient Egypt in Civilizations of the Ancient near East vol II New York 1995.
31. Eugene Hillman, Poligamy Reconsidered: African Plural Marriage and the Christian Churches (New York: Orbis Books, 1975)
32. Mark S. W. Hoyle, The Egyptian Constitution, Arab Law Quarterly, vol. 7 (January 1992 – January 1993).
33. Fauzi M Najjar, The Application of Sharia Laws in Egypt, Middle East Policy, vol. I 1992,
34. Amr Halid - Historitë e Profetëve, Furkan Ism, Shkup
35. Kihan Balz, Submitting Faith to Judicial Scrutiny through the Family Trial: the Abu Zayd Case, Die Welt des Islams, vol, 37, no. 2 (July 1997),
36. Carolyn Flucher-Lobban, Islamic Law and Society in the Sudan, London: Frank Cass, 1987,
37. Gratë Në Islam kundrejt grave në traditën judeokristiane Miti & realiteti - Dr. Sherif Abdel Azīm, përktheu : Edin Q. Lohja (Shkodër, Korrik 1996) - Conveying Islamic Message Society Aleksandri 2008.
38. Pozita e gruas në Islam – Dr. Abd ar – Rahman bin Abd Al- Kareem Ash- Sheha përk. European Islamic Research Center.
39. Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2019 = women and man in Albanian 2019 / Instituti i statistikave, drejt.bot . Delina Ibrahimaj Tiranë INSTAT 2019
40. GRATË DHE BURRAT NË KOSOVË 2014-2015 - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Dhjetor 2016.
41. Lesley Hazleton, Israeli Women: The Reality Behind the Myths (New York: Simon and Schuster, 1977)
42. Prof. Dr. Bekir Topallogllu, Gruaja në Islam, Stamboll, 1997
43. Lois Lamja Faruki, Gratë shoqëria muslimane dhe islami, Shkup, 2007

44. Muhamed Ahmed Ken'an Elementet themelore të jetës bashkëshortore. Gostivar, 2004
45. Genişbilgi için bkz. M. Akif Aydın, İslam Osmanlı Aile Hukuku , İstanbul 1985,
46. İlber Ortaylı, "Osmanlı Aile Hukukunda Gelenek, Şeriat ve Örf " , Sosyo-Kültürel Değişme Sürecinde Türk Ailesi
47. İlber Ortaylı, "Anadoluda XVI. Yüzyılda Evlilik İlişkileri Üzerine Bazı Gözlemler " , Osmanlı Araştırmaları , İstanbul 1980,
48. İlber Ortaylı, Osmanlı Toplumunda Aile, İstanbul 2000,
49. Yaşar Kutluay, Hüseyin Atay; Kur'an-ı Kerim ve Türkçe Anlamı, Ankara 1983.
50. Aktaran; Cem Behar – Alan Duben, İstanbul Hâneleri, İstanbul 1996
51. M.E.Khan, Family Planning Among Muslims in India, Delhi 1979,
52. W.S.Goode, World Revolution and Family Patterns, New York 1968
53. Feridun Merter, Köy Ailesinde Meydana Gelen Değişmeler, Ankara 1990
54. Nur Öznel, " İslam ülkelerinde Aile", Aile Politikaları, Ankara 1991
55. J. Palerne, Peregrinations, Lyon, 1606, s. 96'dan naklen Caporal, Bernard, Kemalizmde ve Kemalizm Sonrasında Türk Kadını (1919-1970), Ankara 1982
56. Cem Behar – Alan Duben, İstanbul Hâneleri, İstanbul 1996,
57. Fatıma Aliye- Mahmud Es'ad, Taaddüd-i Zevcât, Kostantınıyye 1316,
58. Fatma Aliye Hanım, Nisvan-ı İslam, Yay. Haz. Mübeccel Kızıltan, Ankara 84
59. Ömer Demirel, "1700-1730 Tarihlerinde Ankara'da Ailenin Niceliksel Yapısı", Belleten LIV / 211
60. Binaz Toprak, Islamand Political Development in Turkey, Leiden: E. J. Brill, 1981, fq. 46-48.
61. Ahmet Tabakoğlu, Türk İktisat Tarihi, 2.Baskı, İstanbul 1994
62. Fanny Davis, The Ottoman Lady- A Social History From 1718 to 1918. New York 1986
63. Abdurrahman Kurt, "Osmanlı'da Kadının Sosyo-Ekonomik Durumu" , Yeni Türkiye Dergisi, Osmanlılar Özel Sayısı, c. 5,

64. Nakleden Cem Behar, "Polygyny in Istanbul, 1885-1926", Middle Eastern Studies, Volume 27, Number 3, July 1991
65. Muhiddin Tuş, "Kayseri Tereke Defterleri Üzerine Bir Araştırma (1700-1730)", Selçuk Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi, sayı 4, Konya 1999,
66. Said Öztürk, "19. Asrın Başlarında Kayseri'de Ailelerin Sosyal Ve Ekonomik Durumu Üzerine Bazı Gözlemler", İÜ, Edebiyat Fakültesi Tarih Dergisi, Prof. Dr. Fikret Işıltan'a Hatıra Sayısı, İstanbul 2000
67. Rifat Özdemir, "Tokat'ta Ailenin Sosyo-Ekonomik Yapısı (1771-1810)", "Türk Tarihinde ve Türk Kültüründe Tokat Sempozyumu (2-6 Temmuz 1986), Ankara 1987
68. Abdurrahman Kurt, Bursa Sicillerine Göre Osmanlı Ailesi (1839-1876), Bursa 1998,
69. Şemseddin Sami, Kadınlar, İstanbul 1311,
70. Kınalızâde Ali Efendi, Devlet ve Aile Ahlakı, Hazırlayan Ahmet Kahraman, Hüseyin Öztürk, Kınalızâde Ali Çelebi'de Aile, Ankara 1990,
71. Safiye Ünüvar, Saray Hatıralarım, İstanbul 1964
72. Aleks Luarasi, Marrëdhëniet familjare në të drejtën zakonore shqiptare, Tiranë 2001,
73. Giovanni Bonilini, përkth.Anila Ismaili, Alketa Ylli, Manual i së drejtës familjare, Tiranë 2005
74. K. Lipstein, The Reception of Western Law in Turkey, Annales de la Faculte de droit d Stamboll, no. 6/ 1956
75. Afrim Osmani, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Furkan ISM -Shkup, 2010,
76. Fatmira Musaj, Gruaja në Shqipëri : (1912-1939), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë 2002
77. Hasan Jashari, Familja dhe bashkësia, Tetovo - SEE University 2006
78. Jordan Daci, Të drejtat e njeriut, Laurasi – Tiranë 2006
79. Arta Mandro-Balili, E drejta romake, Emal – Tiranë 2007
80. Andrew Borkowski, Paul du Plessis, E drejta romake, Tiranë : UET Press
81. Arta Mandro-Balili,, E drejta familjare, Kristalina KH – Tiranë 2007
82. Hamdi Podvorica,, E drejta familjare, Prishtinë 2005

83. Shejh Salih Ibën Salih El-Feuzan, Dispozitat në lidhje me grate besimtare, Mendimi – Shkup 2009.
84. Muhammad A. El-Khalas, Qaddafi: His ideology in Theory and Practise, Brattleboro, Vermont: Amana Books, 1986,
85. Michelle Rinaldo Iversen - The legal status of polygamy in England and Germany - a comparison 2017
86. Antions Elias El-Gemayet, The Libanese Legal System, Georgetown (UK) International Law Institute, 1994.
87. Muhamed Abdulxhevad Muhamed, Razvoj zakonodavstva u islamskom svijetu s posebnim osvrtom na posljednji period osmanskog hilafeta, nga arabishtja Fikret Karčić, Islamska misao, nr. 61 (Janar 1984),
88. Мицковиќ, Д., Семејното право во земјите на Европската Унија: од монистички кон плуралистички концепт на семејството, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Миле Хаџивасилев Вардарски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2004.
89. Мицковиќ, Д., Вонбрачните деца и родителското право во европските земји, Годишник на Правниот факултет во Скопје во чест на проф. Борислав Благоев, Правен факултет во Скопје, 2007.
90. Мицковиќ, Д., Од црковните кон световните норми: Еволуција на брачното право во Европа, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Панта Марна, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2007.
91. Мицковиќ, Д., „Правното регулирање на вонбрачната заедница“, Правник, Здружение на правници на РМ, бр. 195-196, 2008.
92. Мицковиќ, Д., Семејството во Европа XVI-XXI век, Блесок, Скопје, 2008.
93. Мицковиќ, Д., Кодификација на семејното право во европските земји, Кодификација на Македонското трговско и граѓанско право, Ману, Скопје 2009.
94. Мицковиќ, Д., Конзервативците против либералите: Конфликтот околу семејните вредности во европските земји, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“

- во Скопје во чест на проф. Томислав Чокревски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010.
95. Мицковиќ, Д., Францускиот Устав од 1791 година и договорната концепција за бракот, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на про. Владимир Митков, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010.
96. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Промените во семејството и реформите во семејното право во Европските земји“, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Наум Гризо, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2011.
97. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Кодификација на граѓанското право во Европа – утопија или реалност“ Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Петар Манговски, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2011.
98. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Реформите во семејното и наследното право и ингеренциите на нотарите“ Редовно стручно советување на нотарите од Република Македонија 11-13 ноември 2011 година, публикуван во стручното списание, НОТАРИУС, Скопје, декември 2011.
99. Mickovik, D., Ristov, A., The Legal Regulation of the Nonmarital Cohabitation in the Macedonian Family Law, International Survey of Family Law, 2012.
100. Mickovik, D., Ristov, A., Porodično nasilje u makedonskom kaznenopravnom i porodičnopravnom zakonodavstvu, Porodično nasilje, Beograd, 2012.
101. Micković, D., Ristov, A., Bračni ugovor u makedonskom i uporednom pravu, Pravni život, Beograd, 2012.
102. Мицковиќ, Д., Ристов, А., Положбата на брачниот другар во македонското и споредбеното наследно право, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Тодор Пеливанов, Правен факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2012.

103. Мицковиќ, Д., Ристов, А., „Кодификација на семејното право во Република Македонија“ Зборник радова – Владавина права и правна држава у региону, Универзитет у источном Сарајеву Правни факултет, Источно Сарајево, 2014.
104. Спиновиќ-Трпеновска, Љ., Семејно право, Студентски збор, Скопје, 2004.
105. Спиновиќ Трпеновска, Љ., Семејно право, Правен факултет „Јустинијан Први“ Скопје, 2008.
106. Спиновиќ-Трпеновска, Љ., Бракот и семејството во Бразил, Годишник на Правниот факултет – Скопје, Скопје, 1990/1991.
107. Спиновиќ Трпеновска, Љ., „Аналогија на вонбрачната со брачната заедница“ Зборник во чест на проф. Борислав Благодоев, Скопје, 2007.
108. Спиновиќ Трпеновска, Љ., „Карактеристики на семејното законодавство во Република Македонија“, Семејното законодавство на Република Македонија, Реферати за Републичко советување, Врховен суд на Република Македонија, Скопје, 1994.
109. Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов,, Закон за семејството, Стоби трејд – Скопје 2015
110. Кирил Чавдар, Цветанка Силјаноска Костадиновска,, Законот за семејството : коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература, Агенција Академик – Скопје 2013
111. Blair Marianne D. & Блер Мариен Д. & Merle H. Weiner, & Мерл Х. Вајнер, Меѓународно семејно право : конвенции, статuti и регулаторни материјали, Магор – Скопје, 2009
112. Љиљана Спиновиќ Трпеновска, & Дејан Мицковиќ, & Ангел Ристов, Семејно право, Културна Установа Блесок, 2013
113. Дејан Мицковиќ, Семејството во Европа : XVI-XXI век, Културна Установа Блесок, 2008
114. Yasaroglu, M. Kamil, Pakistçin'da Islâm Ceza Hukuku'nun Kanunlaştırılması, Istanbul, 1996

115. Altuğ Yılmaz, 'İslam Ülkelerinde Poligami Konusu', Mukayeseli Hukuk Araştırmaları Der.gisi, No: 15, İstanbul, 1983,
116. Celal Nuri, Kadınlarımız, İstanbul, 1331,
117. Muhammed Ubeydullah, Müslümanlığa Göre Bir Erkek Dört Karı Alabilir mi, 1924,
118. Mansurizade, Said, "Şeriat ve Kanun", Daru'fünun Hukuk Fak. Mec., İstanbul, 1332
119. Tabakoğlu, Ahmet, 'Batıda Aile ve Kadın', Sosyal Hayatta Kadın, İstanbul, 1996,
120. Ortaylı, İlber, Türkiye'de Ailenin Değişimi ve Toplumbilimsel İncelemeler. Ankara, 1984,
121. Human Rights Education Associates (HREA) THE MOROCCAN FAMILY CODE (MOUDAWANA) of February 5, 2004(An unofficial English translation of the original Arabic text)
122. Tunisian Family Law - British Embassy Tunis
123. Ann Elizabeth Mayer, In Search of Sacred Law:the Meandering Course of Qadhafis Legal Policy, në: Qadhafis Libya 1969-1994, ed. by Dirk Vandewalle, New York: St. Martins Press

Akte ligjore, kode

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991
2. Ligji për familje (Gazeta zyrtare e RM, Nr.38/2004)
3. КРИВИЧЕН ЗАКОНИК („Службен весник на Република Македонија" број 80/99..)
4. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut
5. Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Gruas
6. ،1984، القانون رقم 84-11 المؤرخ في 9 رمضان عام 1404 الموافق 9 يونيو سنة 1984، (Ligji Nr. 84-11, i 9 Ramazanit 1404, që korrespondon me 9 Qershor 1984,).
7. 1959، "لسنة" 188 رقم وتعديلاته قانون الأحوال الشخصية رقم "188" لسنة 1959، (Ligji Nr. 188, i vitit 1959, Ligji për familjen, i ndryshuar dhe plotësuar.)
8. 1953/59، قانون الأحوال الشخصية في الجمهورية العربية السورية (Ligji i statusit personal në Republikën Arabe Siriane (59/1953)

9. ظهور شريف رقم 1.44.22 صادر في 12 من ذي تاحجة 1424 (3 فبراير 2004) بتنفيذ القانون رقم 70.03 بمثابة مدونة الاسرة
10. Criminal Code Law Nr. 5237 - Passed On 26.09.2004 - (Official Gazette No. 25611 dated 12.10.2004)- FIRST VOLUME
11. TÜRK MEDENİ KANUNU - Kanun Numarası : 4721 Kabul Tarihi : 22/11/2001 Yayımlandığı Resmî Gazete : Tarihi : 8/12/2001 Sayı : 24607 Yayımlandığı Düstur : Tertip : 5 Cilt : 41 (LIGJI CIVIL TURQI - Numri ligjor: 4721 Data e pranimit: 22/11/2001 Gazeta Zyrtare: Data: 8/12/2001 Numri: 24607 Botuar: Kodi: 5 Vëllimi: 41)
12. LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS
13. KODI I FAMILJESI REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIGJ Nr. 9062, datë 8.5.2003
14. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIGJ Nr.7895, datë 27.1.1995

Burime nga interneti

1. <http://www.pravo.org.mk/>
2. <http://makstat.stat.gov.mk/>
3. <https://www.zeriamerikes.com/>
4. <http://bilalphilips.com/islams-position-on-polygamy/>
5. <https://islamqa.info/ar/answers/14022/%D8%AD%D9%83%D9%85-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D8%AF-%D8%A7%D9%84%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA-%D9%88%D8%A7%D9%84%D8%AD%D9%83%D9%85%D8%A9-%D9%85%D9%86%D9%87>
6. https://www.wakf.com/attachments/article/102/polygamy_in_islamic_law.pdf
7. <http://www.fakte.mk/fshati-ku-grate-kane-2-3-burra-kurse-vendi-quhet-lugina-e-lumturise-2/>
8. <https://sq.insterne.com/si-te-martohesh-ne-liban/>
9. <https://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opendocpdf.pdf?reldoc=y&docid=5c76654f4>

10. <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=107>
11. <https://alqabas.com/article/584105-1251-%D8%AD%D8%A7%D9%84%D8%A9-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D9%91%D8%AF-%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA-%D9%81%D9%8A-%D8%A7%D9%84%D9%83%D9%88%D9%8A%D8%AA-%D8%AE%D9%84%D8%A7%D9%84-2017>
12. <https://sq.insterne.com/informacion-mbi-licencen-e-marteses-ne-egjipt>
13. <https://internasional.republika.co.id/berita/internasional/timur-tengah/14/08/08/n9ylfx-cegah-poligami-kerajaan-arab-saudi-perketat-aturan-pernikahan>
14. <https://www.aljazeera.net/news/miscellaneous/2013/2/6/%D9%84%D9%8A%D8%A8%D9%8A%D8%A7-%D8%AA%D8%B1%D9%81%D8%B9-%D8%A7%D9%84%D9%82%D9%8A%D9%88%D8%AF-%D8%B9%D9%86-%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D8%AF-%D8%A7%D9%84%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA>
15. <https://www.sudantribune.net/%D8%AA%D8%B9%D8%AF%D9%91%D9%8F%D8%AF-%D8%A7%D9%84%D8%B2%D9%88%D8%AC%D8%A7%D8%AA>
16. <https://www.botasot.info/maqedonia/935245/cdo-i-teti-femije-ne-maqedoni-eshte-jashte-martese-ne-be-cdo-i-dyti/>